



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosova**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

---



# **RAPORTI VJETOR**

## **PËR VITIN 2012**

**Prishtinë, shkurt 2013**

## Përmbajtja

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>4</b>
a. Të hyrat dhe shpenzimet .....	4
b. Promovimi i zhvillimit ekonomik .....	5
c. Administrata komunale .....	6
d. Arsimi .....	7
e. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale .....	8
f. Kultura, rinia dhe sporti .....	9
g. Infrastruktura, urbanizmi dhe shërbimet publike .....	9
h. Ndërmarrjet publike komunale .....	10
i. Qeverisja komunale dhe bashkëpunimi ndërinstitucional .....	11
j. Transparenca, komunikimi dhe përfshirja e qytetarëve në qeverisje .....	12
k. Siguria publike .....	13
l. Bashkëpunimi ndërkombëtar .....	13
<b>II. MBLEDHJET E KUVENDIT, EKZEKUTIVIT DHE TRUPAVE PUNUESE .....</b>	<b>14</b>
<b>III. AKTIVITETET E DREJTORIVE.....</b>	<b>14</b>
1. DREJTORIA E FINANCAVE DHE E PRONËS .....	14
a. Buxheti për vitin 2012.....	14
b. Të hyrat vetanake .....	14
c. Shpenzimet buxhetore .....	15
d. Sektori për buxhet dhe financa.....	17
e. Sektori i tatimit në pronë të paluajtshme.....	17
f. Sektori i pronës .....	18
2. DREJTORIA E ARSIMIT.....	19
a. Të dhënat për institucionet arsimore dhe nxënësit .....	19
b. Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor .....	19
c. Ngritja e infrastrukturës shkollore gjatë vitit 2012 .....	20
d. Aktivitetet e tjera të drejtorisë.....	21
e. Shërbimi i administratës.....	21
3. DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE .....	22
a. Investimet dhe ngritja e kapaciteteve në shëndetësi .....	22
b. Stafii i angazhuar në shërbimet shëndetësore.....	23
c. Të dhënat për shërbimet shëndetësore .....	24
d. Mirëqenia sociale .....	25
e. Ngritja e kapaciteteve njerëzore në shëndetësi.....	26
f. Furnizimi me barna dhe material shpenzues .....	27
4. DREJTORIA E EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT .....	27
a. Sektori i ekonomisë.....	27
b. Sektori për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural .....	28
c. Shërbimi i pylltarisë.....	29
5. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT .....	30
a. Sektori i urbanizmit.....	30
b. Sektori i planifikimit .....	31
c. Sektori i ndërtimit .....	31
d. Sektori i mbrojtjes së mjedisit.....	31
e. Sektori i legalizimit.....	32
6. DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS LOKALE .....	32
a. Vëllimi financiar dhe fizik i projekteve të realizuara .....	33
b. Projektet infrastrukturore të bartura nga viti 2011 .....	33
c. Projektet infrastrukturore të kontraktuara në vitin 2012 .....	34
d. Hartimi i projekteve dhe detyrave projektuese .....	36
7. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT .....	37
a. Investimet kapitale .....	37
b. Shënimi i ngjarjeve të rëndësishme.....	38

c.	Mbështetja e organizatave kulturore, rinore dhe sportive .....	38
d.	Institucionet kulturore ndërkomunale .....	39
8.	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJES DHE SHPËTIMIT .....	40
a.	Sektori i shërbimeve publike.....	40
b.	Sektori i mbrojtjes dhe shpëtimit .....	42
c.	Bashkëpunimi dhe donacionet .....	44
9.	DREJTORIA E KADASTRIT.....	44
10.	DREJTORIA E INSPEKSIONIT .....	46
a.	Sektori i ndërtimit .....	47
b.	Sektori komunal dhe i mbrojtjes së ambientit .....	47
c.	Sektori i komunikacionit.....	47
d.	Sektori sanitar - veterinar .....	48
e.	Sektori bujqësor .....	48
11.	DREJTORIA E ADMINISTRATËS.....	48
a.	Investimet kapitale .....	48
b.	Sektori për punë të Kuvendit dhe ekzekutivit .....	48
c.	Sektori i bashkësive lokale.....	49
d.	Sektori teknik.....	49
e.	Sektori i punëve të përgjithshme.....	49
f.	Sektori i gjendjes civile.....	49
g.	Zyra për teknologji informatike .....	50
<b>IV.</b>	<b>AKTIVITETET E ZYRAVE DHE NJËSIVE .....</b>	<b>50</b>
a.	Njësia e personelit.....	50
b.	Departamenti i Prokurimit .....	51
c.	Zyra për marrëdhënie me publikun .....	52
d.	Zyra ligjore .....	52
e.	Zyra e përfaqësimit juridik.....	53
f.	Njësia për auditim të brendshëm.....	53
g.	Zyra komunale për integrim evropian .....	54
h.	Njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore .....	54
i.	Zyra për kthim dhe komunitete .....	55

### Tabelat

Tabela 1:	Lëndët e pranuar sipas drejtorive për vitin 2012.....	6
Tabela 2:	Planifikimi dhe realizimi i të hyrat vetanake në vitin 2012 .....	15
Tabela 3:	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2012 .....	16
Tabela 4:	Raporti i shërbimeve shëndetësore për vitin 2012 .....	24
Tabela 5:	Raporti i shërbimeve shëndetësore të QMU-së për vitin 2012 .....	25
Tabela 6:	Numri i familjeve në asistencë sociale, sipas QPS, gjatë muajve të vitit 2012.....	26
Tabela 7:	Projektet infrastrukturore të bartura nga vitit 2011 .....	33
Tabela 8:	Projektet infrastrukturore të kontraktuara në vitin 2012.....	34
Tabela 9:	Statistikat për intervenimet nga zjarrfikësit gjatë vitit 2012 .....	43
Tabela 10:	Statistikat për intervenimet nga zjarrfikësit gjatë vitit 2012, sipas komunave.....	44
Tabela 11:	Numri dhe struktura e të punësuarve në administratën komunale (2012).....	50

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Ky raport i Kryetarit të Komunës paraqet aktivitetet e organeve komunale gjatë vitit 2012. Qëllimi i tij është të prezantohen puna dhe arritjet specifike të administratës komunale, sfidat, si dhe masat që janë ndërmarrë gjatë periudhës raportuese. Raporti është në përputhje me kërkesat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për raportim vjetor të Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal. Raporti përmban informata për punën e të gjitha drejtorive dhe zyrave në kuadër të Komunës, si dhe disa informata për punën e ndërmarrjeve publike komunale në ofrimin e shërbimeve për qytetarë (informata më detale për këto ndërmarrje jepen në raportimin e tyre vjetor të paraqitur në Kuvendin e Komunës).

### **a. Të hyrat dhe shpenzimet**

Komuna e Prishtinës për vitin 2012, ka pasur një buxhet prej 61,741,684 Euro, prej të cilave 35% nga të hyrat vetanake. Ky buxhet është rritur edhe për 1.4 mil. euro si rezultat i arkëtimit më të lartë të të hyrave vetanake, ku është arritur performancë e mirë. Janë mbledhur 23.2 milion euro, apo 7% më shumë se plani vjetor i të hyrave vetanake. Si rezultat, pjesëmarrja e të hyrave vetanake në buxhetin total të Komunës ka arritur nivelin prej 36.5%. Kjo përqindje është mjaft e lartë kur kihet parasysh se komunat janë zhveshur nga niveli qendror nga çfarëdo tatimit që mund të mbledhin. Kujtojmë se i vetmi tatim që tani komunat mbledhin është tatimi në pronën e paluajtshme, derisa të hyrat e tjera janë taksa që reflektojnë vetëm koston e shërbimit që komuna ofron për qytetarë. Taksa të tilla janë edhe të hyrat nga lejet e ndërtimit, të cilat megjithatë nuk mjaftojnë për të ofruar infrastrukturën e plotë publike për ndërtimet e reja, sidomos në lagjet e pa urbanizuara plotësisht. Të hyrat nga lejet e ndërtimit (të cilat për vitin 2012 përbëjnë 59.8 për qind të të hyrave të përgjithshme vetanake) dhe të hyrat nga tatimi në pronën e paluajtshme (16.6 për qind) vazhdojnë të mbeten burime kryesore të të hyrave vetanake.

Si rezultat i problemeve pronësore të trashëguara më parë, mungesës së dokumentacionit të plotë pronësor, procedurave të stërzgjatura prokurimit dhe krizës ekonomike që po e përcjell ekonominë e vendit, Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2012 ka arritur të shpenzojë 80 për qind të buxhetit të planifikuar për këtë vit. Shpenzimet për paga dhe mëditje janë realizuar tërësisht, për mallra dhe shërbime 97 për qind, për shpenzime komunale 97 për qind, për subvencione dhe transfere 99 për qind, dhe për investime kapitale 60 për qind.

Sikurse edhe në vitet e kaluara, Komuna ka vazhduar bashkëpunimin e mirë me donatorë të ndryshëm. Si rezultat i kësaj janë bërë investime kapitale në shkolla, ujësjellës, ngrohje etj. Vetëm në shërbime publike janë tërhequr donacione në vlerë prej 1.8 milion euro. Donacione ka pasur edhe në arsim dhe në fushat e tjera. Komuna ka qenë mjaft aktive në përgatitjen e projekteve për tërheqjen e donacioneve nga organizata dhe institucione të ndryshme. Komuna, së bashku me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW), ka përkrahur me mjete financiare projektin për përmirësimin e ujësjellësit dhe ndërtimin e fabrikës së re të përpunimit të ujit. Komuna pritet të investojë 5 milion euro, së bashku me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW), i cili projekt vlerësohet në 35 milion euro dhe pritet të

vazhdojë edhe gjatë viteve 2013 dhe 2014. Sipas marrëveshjes me Bankën Gjermane dhe Qeverinë e Kosovës, Komuna ka ndarë mjetet edhe për projektin e koogjenerimit të ngrohjes së Termokosit, projekt ky i përkrahur edhe nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW), Komisioni Evropian dhe Qeveria e Kosovës. Ky projekt ka filluar të zbatohet, pasi që janë nënshkruar marrëveshjet për financim dhe hua, është shpallur tenderi nga ana e KfW-së për konsulencë teknike, e cila do të përgatisë dokumentet e nevojshme teknike për investime. Donatorët si USAID, SWISSCONTACT dhe Banka Botërore, kanë mbështetur Komunën në ndërtimin e disa shkollave dhe anekseve shkollore.

## **b. Promovimi i zhvillimit ekonomik**

Me qëllim të promovimit të zhvillimit ekonomik të komunës, Komuna e Prishtinës ka bashkëpunuar me institucione financiare të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Janë zhvilluar një sërë takimesh me përfaqësues të Bankës Botërore, Bankës Gjermane për Zhvillim, Fondit Monetar Ndërkombëtare, Odave Ekonomike, si dhe janë vizituar një numër i kryeqyteteve të vendeve të BE-së për të nxitur bashkëpunimit institucional dhe ekonomik të Prishtinës me këto qytete. Përmes takimeve të drejtpërdrejta, konferencave dhe tryezave të ndryshme që janë mbajtur me përfaqësues të biznesit, investitorë lokalë dhe ndërkombëtar, si dhe takimet me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse, Kryetari i Komunës ka promovuar mundësitë që ofron Prishtina për të investuar. Në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë për Zhvillimin Rajonal - Qendër, Komuna ka hartuar projekt-propozime për investime nga donatorë të ndryshëm, sidomos nga fondet e Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA) të Komisionit Evropian. Si rezultat është arritur që të nënshkruhet kontrata me KE për rehabilitimin dhe rigjenerimin e Parkut të Gërmisë, ku Komisioni Evropian i jep Komunës si donacion 360 mijë euro.

Komuna ka zhvilluar një numër të takimeve me Odën Ekonomike të Kosovës dhe asociacione të tjera të biznesit për të adresuar problemet dhe shqetësimet e tyre, sidomos sa i përket marrjes së lejeve të ndërtimit. Si rezultat i këtyre takimeve, është marrë vendim për krijimin e një njësie të veçantë për trajtimin e kërkesave për leje nga kompanitë ndërtimore, si dhe për heqjen e taksës për biznese. Kujtojmë se heqja e lejes së punës, mos transferi i regjistrimit të bizneseve nga MTI-ja në Komunë, si dhe transferimi i inspektionit të tregut nga Komuna në MTI, e ka zhveshur Komunën nga çfarëdo kompetence në lidhje me promovimin e zhvillimit ekonomik në komunë. Menaxhmenti i Komunës ka theksuar vazhdimisht se ky centralizim kompetencash është në kundërshtim me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Në vazhden e projekteve për zvogëlimin e papunësisë, Komuna, në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Punësimit, ka realizuar projektin “ Trajnimi i të rinjve në punë në ndërmarrësi”, ku 30 të rinj të papunë janë trajnuar direkt në punë, dhe për këtë janë kompensuar me nga 130 € në muaj. Projekti ka zgjatur 6 muaj. Komuna e Prishtinës është përfutuese e projektit “ One Stop Shop”, projekt ky që është shumë i rëndësishëm, sidomos për komunitetin e biznesit. Janë trajnuar mbi 450 biznese ekzistuese dhe fillestare. Njëkohësisht është bërë edhe trajnimi i stafit nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit për regjistrimin e bizneseve, sepse presim delegimin e kompetencave nga MTI-ja, gjegjësisht Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Komunë. Mungesa e bartjes së regjistrimit të bizneseve nga MTI në Komunë, e ka kufizuar kapacitetin e kësaj zyre. Kjo gjë po e pamundëson që të ofrojmë

të dhëna më detale për numrin e bizneseve që operojnë në Prishtinë dhe numrin e të punësuarve të tyre. Me ligjin e ri për tregti të brendshme, janë hequr lejet e punës që Komuna ka lëshuar për bizneset që operojnë në komunën e Prishtinës.

Në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, Komuna ka ndarë 435,000 euro subvencione për mbjelljen e patates, serrave, vaksinim të gjedheve, shpesëri, blegtori, bletari etj. Mbjelljet vjeshtore dhe pranverore janë përkrahur nga Komuna me 100,000 €, ku kanë përfituar gjithsej 509 fermerë, me një sipërfaqe të përgjithshme 895.5 ha, secili me nga 111 €/ha. Janë përkrahur 66 fermerë për mbjelljen e patates, rreth 300 fermerë me nga një serrë, me sipërfaqe 54 m<sup>2</sup>. Janë përkrahur 4 fermerë komercialë me gjithsej 14,000 pula vojse, me ushqim të koncentruar në sasi prej 79,940 kg ushqim të koncentruar. Të gjitha këto aktivitete po kontribuojnë në rritjen e punësimit në zonat rurale dhe në parandalimin e braktisjes së zonave rurale dhe kodrinore-malore të komunës.

### c. Administrata komunale

Komuna ka investuar në objektin e ri dhe të vjetër, si dhe në zyrat e tjera komunale, me qëllim të modernizimit dhe rritjes së efikasitetit të ofrimit të shërbimeve për qytetarë në kuadër të administratës komunale. Qendra për shërbime me qytetarë është pajisur me teknologji moderne dhe me staf, në përputhje me nevojat e qytetarëve. Kjo qendër ka procesuar mbi 48,000 kërkesa të ndryshme (dhe mbi 11,000 kërkesa të tjera janë procesuar përmes librit të protokollit). Secila drejtori dhe njësi komunale e ka zyrtarin e saj në kuadër të kësaj qendre për ofrim të drejtpërdrejtë të shërbimeve me qytetarë. Tabela në vijim paraqet numrin e lëndëve të trajtuara nga kjo qendër, sipas drejtorive. Shumica e kërkesave të pranura (apo 89%) janë shqyrtuar. Vetëm 7% të kërkesave janë të pakryera, të cilat kryesisht kanë arritur gjatë javëve të fundit të muajit dhjetor, të cilat procesohen në javët e para të vitit vijues.

Tabela 1: Lëndët e pranura sipas drejtorive për vitin 2012

Drejtoritë	Pranura	Të shqyrtuara				Proces	Pakryera
		Miratuara	Refuzuar	Hedhura poshtë	Pezulluar		
1. Drejtoria e Administratës	8,781	6,906	162	78	6	4	1,625
2. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	2,267	1,028	1,011	1	4	-	223
3. Drejtoria e Arsimit	2,280	459	1,368	11	437	-	5
4. Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit	2,821	2,107	552	-	81	19	62
5. Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	1,392	989	-	-	-	-	403
6. Drejtoria e Infrastrukturës Lokale	683	77	-	-	603	-	3
7. Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit	1,281	548	18	-	713	-	2
8. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	661	424	197	-	5	30	5
9. Drejtoria e Inspekcionit	4,090	3,526	1	-	-	2	561
10. Drejtoria e Financave dhe Pronës	17,885	17,363	181	-	12	52	277
11. Drejtoria e Kadastrit	6,274	5,790	59	-	48	37	340
Gjithsej	48,415	39,217	3,549	90	1,909	144	3,506

Numri i shërbyesve civilë në administratën komunale është 750, që është më i lartë se në vitin e kaluar, për shkak të rekrutimeve të reja që janë bërë, kryesisht në sektorët ku Komuna ka më së shumti nevojë, si në Urbanizëm, Infrastrukturë etj. Për shkak se të punësuarit e rinj janë kryesisht me arsim të lartë, kjo ka ndikuar në rritjen e nivelit arsimor të të punësuarve në administratën komunale. Derisa në vitin 2009, 26% të punëtorëve kanë qenë mepërgatitje superiore - fakultet, në vitin 2012 është rritur në 34%. Kjo po ndikon në përmirësimin e shërbimeve për qytetarë.

Në kuadër të angazhimit për përmirësimin e shërbimeve për qytetarë, Komuna ka funksionalizuar Zyrat e Vendit në Llukar dhe Viti e Marecit. Varësisht nga kushtet teknike, Komuna do të hapë zyra të ngjashme edhe në lokacione të tjera të komunës. Gjatë kësaj periudhe kohore janë përgatitur dhe mbajtur zgjedhjet për këshilla dhe kryetarë të këshillave në 33 bashkësi lokale në tërë territorin e komunës së Prishtinës. Zyrat e bashkësive lokale kanë kryer shërbime administrative të ndryshme, ku sipas kërkesave të palëve, janë lëshuar gjithsej 27,718 vërtetime për rregullimin e dokumentacionit personal, të drejtave në asistencë sociale, të drejtave të qytetarëve që përkohësisht jetojnë dhe punojnë në botën e jashtme etj.

Komuna ka ende vështirësi, sidomos sa i përket lëshimit të dokumentacionit kadastral dhe të dëshmive të tatimit në pronën e paluajtshme, pasi programi kompjuterik për të dyja këto shërbime menaxhohen nga niveli qendror (nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe nga Ministria e Financave, respektivisht). Me gjithë përpjekjet e Komunës në rritjen e efikasitetit të punës në këta dy sektorë, palët ende presin më gjatë sesa duhet për shkak se sistemi “on-line” i procedimit të këtij lloji dokumentacioni menaxhohet nga niveli qendror.

#### **d. Arsimi**

Në fushën e arsimit, gjatë vitit 2012 janë lëshuar në punë disa objekte shkollore, anekse dhe salla të edukatës fizike dhe ka filluar ndërtimi i disa objekteve tjera shkollore dhe objekteve të sportit. Me objektet e reja, të cilat janë inauguruar këtë vit shkollor, është shtuar hapësira mësimore për 20,235 m<sup>2</sup>. Në krahasim me vitin e kaluar, hapësira për kokë nxënësi është rritur nga 1.60 m<sup>2</sup> për kokë nxënësi sa ka qenë në vitin 2011, në 1.77 m<sup>2</sup> për kokë nxënësi. Kjo është një rritje për 11% të hapësirës për kokë nxënësi, me të cilën gjë është eliminuar ndërrimi i tretë në shkollat fillore dhe të mesme të komunës.

Megjithatë, me rreth 49,650 nxënës në arsimin para-universitar, klasat janë të mbingarkuara me nxënës, me 24 nxënës për klasë në arsimin fillor (që është për 20% më shumë se standardi i lejuar prej 21 nxënës për klasë) dhe me 33 nxënës për klasë në arsimin e mesëm (që është për 62% më shumë se standardi i lejuar për klasë). Institucionet private të arsimit para-universitar po kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë dhe kushteve në institucionet arsimore në komunë, duke absorbuar rreth 6% të nxënësve në nivel komune.

Shpërndarja e padrejtë e buxhetit për investime në arsim nga ana e MASHT-it po pamundëson që të arrihen standardet e nevojshme në ofrimin e hapësirës mësimore.

Komuna e Prishtinës vazhdimisht është e diskriminuar në ndarjet buxhetore për ndërtimin e shkollave fillore e të mesme, që MASHT-i po i ndërton në komuna në kundërshtim me Ligjin për arsim komunal. Ky ligj e definon qartë se buxheti për ndërtimin e shkollave duhet tu alokohet komunave, sipas nevojave të tyre, e jo shkollat të ndërtohen drejtpërdrejt nga MASHT-i, pa ndonjë analizë paraprakë të nevojave aktuale dhe afatgjate për hapësirë shkollore. Si rezultat i kësaj, përderisa në Prishtinë numri i nxënësve për klasë arrin mesatarisht në 34, në shumë komuna shkollat e ndërtuara para dy-tri viteve nga MASHT-i, po mbyllen në mungesë të nxënësve.

#### **e. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale**

Në fushën e shëndetësisë, orientimi ka qenë në fuqizimin e rolit të Mjekësisë Familjare në ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Janë bërë investime të konsiderueshme në zgjerimin e hapësirave të Qendrave të Mjekësisë Familjare dhe modernizimin e tyre. Nga muaji gusht i vitit 2012, QMF Mati 1 ka filluar të ofrojë shërbime shëndetësore për banorët e këtij lokaliteti, dhe vetëm gjatë periudhës 5-mujore (gusht - dhjetor 2012) janë ofruar rreth 3,500 shërbime shëndetësore në këtë QMF. Është përmbyllur ndërtimi i QMF-së IV në rrugën “Bajram Bahtiri” (te Medreseja), me një sipërfaqe prej 1,220 m<sup>2</sup>, ku do të ofrohen shumica e shërbimeve shëndetësore të nivelit parësor: mjekësia familjare, pediatrike, stomatologjike, e vaksinimit dhe laboratorike. Për herë të parë, në këtë pjesë të qytetit ofrohen edhe shërbimet e rëntgenologjisë. Ka filluar ndërtimi i QMF-së në Besi, i Ambulancës Shëndetësore në Bardhosh dhe në Barilevë. Janë bërë renovime dhe përmirësime në infrastrukturën dhe hapësirat e shumë QMF-ve, inventarizimi dhe pajisja e tyre me inventar dhe pajisje mjekësore të nevojshme.

Sfidë e vazhdueshme edhe më tej mbetet mungesa e spitalit të qytetit, si dhe kufizimet në punësimin e stafit të ri shëndetësor. Edhe gjatë vitit 2012, stafi shëndetësor prej 135 mjekëve të fushave të ndryshme dhe 47 stomatologëve, ka mbetur i njëjtë me vitin paraprak, pavarësisht kërkesave të mëdha për shërbime shëndetësore. Ky staf ka ofruar rreth 1.9 milion shërbime të ndryshme shëndetësore për qytetarë. Pajisja e institucioneve shëndetësore me barna dhe material shpenzues ka qenë në nivel më të mirë se në vitin paraprak, për shkak të ngritjes së nivelit të planifikimit të shpenzimit të barnave. Këtë vit është investuar dukshëm edhe në ngritjen profesionale të stafit shëndetësor, përmes trajnimeve, seminareve etj.

Në fushën e mirëqenies sociale, pas ndarjes së 50 banesave për familjet me përkujdesje sociale në vitin 2011, Komuna e Prishtinës edhe në vitin 2012 ka vazhduar me ndarjen e banesave. Kësaj radhe janë ndarë banesa për 50 familje të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së, duke u dhënë atyre në shfrytëzim me qira banesa në objektin banesor kolektiv te Fusha e Pajtimit. Në ndërkohë, janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e ndërtimit edhe të 100 banesave të tjera, të cilat pritet të përfundojnë brenda vitit 2013, ku 50 prej tyre do t'u dedikohen familjeve në asistencë sociale, dhe 50 banesa të tjera familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së. Nëse numërojmë të gjitha këto së bashku, del se gjithsej 200 familje do ta zgjidhin çështjen e banimit në një periudhë kohore prej më pak se 3 vjetësh (2011-2013). Ky është hapi më i madh që ndonjë komunë apo institucion në vend ka bërë drejt zgjidhjes së çështjes së



banimit për kategoritë të caktuara, në radhë të parë për kategoritë e luftës dhe për familjet me përkujdesje sociale.

#### **f. Kultura, rinia dhe sporti**

Gjatë vitit 2012, në këtë fushë janë investuar 2.6 milionë euro, duke bërë që infrastruktura kulturore, rinore-sportive të përmirësohet. Në fushën e kulturës janë realizuar këto projekte: biblioteka e qytetit të Prishtinës “Hivzi Sylejmani”, është bërë restaurimi i Xhamisë së Çarshisë, restaurimi i Hamamit të Madh etj. Janë mbështetur 232 aktivitete kulturore, ekspozita, botime etj., me një vlerë prej 241,269 euro, si rezultat janë botuar 87 vepra të ndryshme. Në fushën e sporteve janë mbështetur 90 aktivitete të ndryshme në vlerë prej 68,900 euro. Në fushën e rinisë janë mbështetur 36 aktivitete të ndryshme në vlerë prej 27,000 euro. Janë përkrahur shumë veprimtari teatrore, projekte kulturore, klube sportive, sportistë dhe organizata rinore.

#### **g. Infrastruktura, urbanizmi dhe shërbimet publike**

**Në fushën e infrastrukturës,** për shkak të nevojave të shumta që ka Prishtina, gjatë viti 2012, Komuna ka investuar pjesën më të madhe të buxhetit të saj në projekte, si në ndërtimin e: rrugëve, shesheve, kanalizimit, rindërtimin e rrugëve ekzistuese, si dhe në ndriçim sipas standardeve ndërkombëtare. Komuna gjatë 2012 ka investuar në ndërtimin e 36 km rrugë të reja, 17,506.5 m<sup>2</sup> trotuare, 17.2 km rrjet të ri të kanalizimit fekal, 4,450 metra kanalizim atmosferik, si dhe 4,022 metra rrjet të ri të ujësjellësit. Të gjitha këto kanë përmirësuar dukshëm jetën e qytetarëve, por nevojat ende mbesin të mëdha dhe, si rezultat, Komuna do të vazhdojë investime madhore në infrastrukturë edhe gjatë vitit 2013. Një numër i projekteve nuk janë realizuar, kryesisht për shkak të problemeve pronësore, procedurave të zgjata dhe të përsëritura të prokurimit, si dhe nivelit të ulët teknik të kompanive që fitojnë kontratat për realizim të projekteve. Këto projekte janë bartur në vitin 2013.

**Në fushën e urbanizmit,** Drejtoria e Urbanizmit ka trajtuar 2001 kërkesa të ndryshme dhe nga tarifat dhe ngarkesat komunale, si dhe tarifat për rregullimin e tokës ndërtimore, për këtë periudhë ka arritur të arkëtojë shumën prej 13.8 milionë euro. Drejtoria e Urbanizmit ka lëshuar 208 leje ndërtimi dhe 237 leje urbanistike. Në hartim e sipër është Plani zhvillimor komunal, Plani zhvillimor urban, si dhe planet rregulluese për “Prishtina e Re”, me tri zona: Zona perëndimore, Zona qendrore dhe Zona lindore. Ndërkohë që janë në proces të hartimit edhe plani rregullues “Mati 2” dhe plani rregullues “Kodra e Trimave 1”. Tek Sektori i legalizimeve, janë lëshuar 75 leje të legalizimit për objekte të ndërtuara pa leje, janë caktuar 167 kushte urbanistiko-teknike, janë refuzuar 5 kërkesa dhe ato kryesisht janë rastet që kanë ndërtuar në hapësira publike, si dhe në 1873 raste janë lëshuar kërkesa për plotësimin e lëndëve. Gjatë procesit të hartimit të PZHU-së dhe PZHK-së, si dhe planeve rregulluese për Prishtinën e Re, janë mbajtur shumë diskutime me ekspertë të fushës dhe qytetarë. Me ekspertizë të veçantë në hartimin e këtyre planeve, kanë kontribuar edhe ekspertë nga vendet e Bashkimit Evropian.

**Në fushën e shërbimeve publike** është investuar dukshëm në zgjerimin e hapësirave gjelbëruese dhe mirëmbajtjen e hapësirave ekzistuese të gjelbëruara, është miratuar Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave, konform ligjit të ri, është hartuar plani për riciklimin e mbeturinave, janë mirëmbajtur më shumë rrugët dhe trotuar se më parë gjatë sezonit dimëror dhe vjeshtor, janë modernizuara dhe shtuar disa nyja semaforike dhe vendndalje të autobusëve urban etj. Në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit, ekipi i zjarrfikësve ka qenë shumë i angazhuar gjatë sezonit të verës, për shkak të zjarreve të shumta nëpër lokacione kodrinore-malore të komunës, që janë paraqitur kryesisht nga moti shumë i nxehtë.

#### **h. Ndërmarrjet publike komunale**

Kompanitë publike lokale i kanë dorëzuar raportet e tyre vjetore në Kuvendin e Komunës në tremujorin e parë të vitit 2012. Raportet tregojnë se disa prej këtyre ndërmarrjeve lokale po tregojnë afarizëm negativ dhe po përballën më vështirësi në funksionimin e tyre dhe në ofrimin e shërbimeve për qytetarë.

Në **NPK “Termokos”**, pasi që është nënshkruar marrëveshja me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe Ministrinë e Financave për projektin e ko-gjenerimit për ngrohje të qytetit nga avulli i KEK-ut, ky projekt ka filluar së zbatuari. Në këtë projekt, Komuna ka participuar me 2 milionë €, si dhe do të garantojë për investimet që KfW do të bëjë në “Termokos” me 5 milion euro. Projekti pritet të realizohet dhe të jetë në funksion në sezonin e ngrohjes 2013/2014. Pas zbatimit të këtij projekti, pritet të përgjysmohet kostoja e ngrohjes për qytetarë, si dhe do mundësohet zgjerimi i rrjetit në shumë pjesë të tjera të qytetit. Për shkak të arkëtimit të ulët, Komuna ka përkrahur Temorkosin me subvencione, për të mundësuar fillimin e sezonit të ngrohjes dhe për të mbajtur këtë kompani operative, që ka qenë edhe kusht për financim nga ana e KfW.

**NPK “Trafiku Urban”** po përballlet me vështirësi në sigurimin e të hyrave të nevojshme për të bërë investime të mëdha kapitale në zëvendësimin e autobusëve, të cilët janë të stërvjetëruar dhe nuk i plotësojnë kushtet minimale për operim. Komuna ka angazhuar një ekip të ekspertëve të USAID-it, i cili po punon bashkë me zyrtarët komunalë për të përgatitur një studim fizibiliteti, se si të procedohet më tutje me këtë kompani. Komuna po ashtu ka aplikuar në JICA (Agjencia e Qeverisë Japoneze për Zhvillim Ndërkombëtar) për furnizim me autobusë të rinj. Ky donacion pritet të arrijë vitin e ardhshëm, nëse kërkesa e Komunës miratohet përfundimisht edhe nga Qeveria japoneze në Tokio, pas miratimit në parim që ka marrë nga zyrat e JICA-së në Prishtinë.

**Kompania “Pastrimi”** ka rritur efikasitetin e funksionimit të saj sa i përket mbledhjes së mbeturinave urbane. Kompania ka marrë donacion nga JICA japoneze 10 kamionë për bartjen e mbeturinave, si dhe është furnizuar nga Komuna me 450 kontejnerë të ri. Kompania po përballlet me arkëtim të ulët nga ana e qytetarëve, megjithëse çmimi për mbeturina nuk është i lartë. Komuna ka vështirësi në ndërmarrjen e masave sa i përket tarifave, financimit, si dhe masat për deponimin e mbeturinave. Ligji i ri për ujë dhe mbeturina nuk i ka definuar dhe fuqizuar kompetencat e komunës në këtë fushë.

**NPK “Sport Marketingu”** ka ofruar shërbimet e rekreacionit për të rinj dhe qytetarë të tjerë në pishinën e Gërmisë dhe në kompleksin në Brezovicë. Komuna po i bën përgatitjet për investime në pishinën e Gërmisë për të ngritur bazamentin, pasi thellësia e madhe e pishinës po konsiderohet e papërshtatshme. Bashkë me këtë investim, do të rregullohet edhe infrastruktura përcjellëse e pishinës. Me një projekt tjetër që Komuna ka me Komisionin Evropian, pritet të rregullohet edhe parkingu ngjitur me pishinë, për të krijuar kushte më të mira për ata që shfrytëzojnë pishinën dhe Parkun e Gërmisë. Megjithatë, të hyrat që po krijon kjo kompani nga aktivitetet e saj, nuk mjaftojnë për të ndërmarrë investime të mëdha kapitale për përmirësimin e infrastrukturës për aktivitete rinore dhe sportive. Prandaj, në të ardhmen duhet të shqyrtohen format e investimeve me partneritet publiko-privat.

**NPK “Hortikultura”** ka punuar ngushtë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, për të zgjeruar dhe mirëmbajtur hapësirat gjelbëruese në qytet. Kjo kompani është përkrahur vazhdimisht nga Komuna në aktivitetet e saj. Nga kjo kompani menaxhohen Parku i Gërmisë dhe Tregu i Automjeteve. Në bashkëpunim me Komunën, kjo kompani ka marrë disa donacione për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e hapësirave publike.

**Ndërmarrja Publike Banesore** ka qenë e angazhuar në menaxhimin e pasurisë së saj dhe ka punuar me Komunën për investimin që do të bëhet në lagjen “Pejton” afër katedrales.

Me ligjin e ri të ndërmarrjeve publike, **Stacioni i Autobusëve në Prishtinë** i ka kaluar në menaxhim Komunës së Prishtinës. Komuna ka themeluar Komisionin e Aksionarëve, në përputhje me dispozitat ligjore, i cili tani është në proces të rekrutimit të bordit të kësaj kompanie. Po punohet në gjetjen e një modaliteti për të bërë një lidhje më funksionale në mes të kësaj kompanie dhe NPK ‘Trafiku Urban’ në mënyrë që transporti publik në qytet të jetë më funksional.

Sa i përket furnizimi me ujë, Komuna e Prishtinës ka përkrahur projektin e ndërtimit të fabrikës së re të ujit me një buxhet prej 5 milion euro. Komuna ka punuar ngushtë me kompaninë e ujësjellësit rajonal “Prishtina” për të kryer procedurat e shpronësimit për gypin e ujësjellësit për fabrikën e ujit në Shkabaj.

#### **i. Qeverisja komunale dhe bashkëpunimi ndërinstytucional**

Komuna e Prishtinës, përkatësisht ekzekutivi i Komunës, i ka kushtuar kujdes të veçantë mënyrës së qeverisjes komunale dhe bashkëpunimit ndërinstytucional. Që kjo qeverisje të jetë sa me funksionale dhe sa me afër qytetarëve, kryetari dhe ekipi tij kanë mbajtur 134 aktivitete/takime me zyrtarë komunalë, 33 vizita në terren për inspektimin e punimeve infrastrukturore, 61 takime koordinimi me grupe punuese, Këshillin e Drejtorëve, Kuvendin e Komunës, komitetet e Kuvendit etj.

Janë mbajtur 65 takime, me qëllim bashkëpunimi dhe koordinimi me institucione, organizata, ndërmarrje publike dhe administratë publike (lokale, rajonale dhe qendrore).

Janë mbajtur 21 takime me institucionet qendrore dhe me përfaqësues të partive politike të nivelit lokal dhe qendror, 19 takime dhe aktivitete jashtë zyrës së Kryetarit, me qëllim të përfaqësimit të interesit të Komunës etj. Kryetari ka marrë pjesë në 34 raste të ceremonive zyrtare vendore dhe ndërkombëtare të natyrës ceremoniale dhe përkujtimore. Me gjithë vullnetin e qeverisë komunale për bashkëpunim, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka arritur t'i plotësojë obligimet e veta kushtetuese në raport me Komunën e Prishtinës. Si rezultat i kësaj, ka ngecur Ligji për kryeqytetin dhe kjo ka pamundësuar krijimin e një baze më të mirë buxhetore për Komunën e Prishtinës dhe të një kapaciteti institucional ligjor më të lartë. Komuna ka bashkëpunuar me ministritë e linjës në realizimin e disa projekteve kapitale.

#### **j. Transparenca, komunikimi dhe përfshirja e qytetarëve në qeverisje**

Zyra për marrëdhënie me publikun (ZMP) përparësi të punës së saj e ka sigurimin e transparencës dhe qasjen publike për punën e administratës komunale, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe të ndërmarrjeve publike lokale, duke u ofruar informata dhe dokumente qytetarëve dhe mediave. Me qëllim të informimit të qytetarëve për aktivitetet e Komunës, kjo zyrë bashkëpunon me të gjitha organet e Komunës, me zyrën për protokoll në Kabinetin e Kryetarit. ZMP ka distribuuar për media numër të madh informatash, lajme, ftesa, komunikata, reagime dhe kumtesa për opinion, të cilat janë plasuar edhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës. Gjatë vitit 2012, nga ZMP-ja janë organizuar konferenca për media, të cilat janë përcjellë nga pothuajse të gjitha mediat elektronike dhe të shkruara. Si rrjedhojë e kësaj, Komuna e Prishtinës, gjatë vitit 2012, ka qenë e pranishme në medie të ndryshme, elektronike dhe të shkruara, në mbi 720 raste, ku janë dhënë informata të ndryshme rreth punës së Komunës. Gjatë vitit 2012, ZMP ka nxjerrë një mori publikimesh, siç është broshura “E drejta për qasje në informata publike”, e punuar në bashkëpunim me OSBE-në. Ka punuar në publikimin e buletinit, ku do të prezantohen projektet e realizuara dhe aktivitete tjera në Komunën e Prishtinës në vitin 2012.

Janë ndërmarrë një sërë aktivitete dhe politikash:

- Pjesëmarrje në konferenca dhe seminare, me qëllim të prezantimit të punës së Komunës, në 24 raste;
- Për identifikimin e nevojave dhe kërkesave të qytetarëve, si dhe të përfshirjes së tyre në qeverisjen e Prishtinës, janë mbajtur 56 takime individuale dhe grupe, me qytetarë të ndryshëm të komunës;
- Janë organizuar 29 takime me medie (konferenca, takime formale dhe jo formale) ku janë diskutuar, prezantuar punët dhe të arriturat e Komunës;
- Janë mbajtur 17 takime individuale me drejtues të medias, me qëllim të identifikimit të mundësive për lehtësimin e punës së gazetarëve;
- Shoqëria civile, si partner në qeverisje, është konsultuar dhe angazhuar nëpërmjet pjesëmarrjes në komisione komunale, si dhe në 18 takime në formën e konsultimit direkt;
- Komuniteti fetar ka qenë i përfshirë në takime dhe konsultime për të trajtuar mundësitë e bashkëpunimit dhe të zgjidhjes së problemeve me të cilat përballohen, janë takuar dhe konsultuar në 9 raste;

- Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 21 tubime me qytetarë për çështje të përgjithshme dhe ato specifike. Përveç debateve të rregullta me qytetarë dhe përfaqësues të lagjeve, janë mbajtur edhe takime të tjera, ku janë shqyrtuar çështjet e statutit, buxhetit etj. Në këto tubime dhe debate janë trajtuar tema të ndryshme, si: planet rregulluese për “Prishtina e Re” me tri zona (Zona perëndimore, Zona qendrore, Zona lindore), Plani zhvillimor urban dhe Plani zhvillimor komunal, debat me përfaqësues të biznesit, debat për buxhetin komunal etj.

#### **k. Siguria publike**

Gjendja e sigurisë publike në Prishtinë në vitet e fundit ka qenë kryesisht stabile, pa ndonjë zhvillim të veçantë. Komuna, bashkërisht me Brigadën e Zjarrfikësve dhe organet e tjera të sigurisë publike, kanë arritur që me sukses të menaxhojnë dhe kontrollojnë situatën e vatrave të zjarrit që janë paraqitur gjatë verës së vitit 2012 në disa zona të komunës. Segmenti i sigurisë publike dhe i mirëqenies së qytetarëve është trajtuar me kujdes nga të gjitha organet komunale dhe organet tjera kompetente të fushës. Kryetari ka qenë i përfshirë në rreth 69 aktivitete, koordinime dhe konsultime me organet e sigurisë. Në 15 raste, Kryetari ka pritur në takim përfaqësuesit më të lartë të KFOR-it, Policisë së Kosovës, FSK-së dhe EULEX-it. Është siguruar koordinim shumë i mirë me organet e sigurisë për rrënimin e ndërtimeve pa leje. Komiteti Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur 7 mbledhje, ku janë diskutuar çështjet e sigurisë dhe janë raportuar nga të gjitha organet e përfshira në ruajtjen e sigurisë publike në komunë.

#### **l. Bashkëpunimi ndërkombëtar**

Bashkëpunimi ndërkombëtarë në mes të Komunës dhe kryeqyteteve të tjera të vendeve të Bashkimit Evropian dhe SHBA-së në vitin 2012, ka shënuar një rritje të theksuar. Kryetari i Komunës ka marrë pjesë në 90 aktivitete/ takime me udhëheqës të kryeqyteteve të BE-së, si dhe përfaqësues të institucioneve relevante ndërkombëtare, qëllimi i të cilave ka qenë ngritja e bashkëpunimit dhe e promovimit të zhvillimit dhe të investimeve. Janë mbajtur 55 takime dhe aktivitete me përfaqësues të ambasadave të vendeve të BE-së, SHBA-së dhe Turqisë. Kryetari i Komunës gjatë këtij viti ka realizuar 8 vizita jashtë vendit. Ky bashkëpunim është zhvilluar dhe avancuar duke u materializuar me vizita shumë të rëndësishme, si në: SHBA, Francë, Belgjikë, Zvicër, Gjermani e shumë vende të tjera, si dhe vizita të partnerëve ndërkombëtarë në Komunën e Prishtinës. Këto vizita janë bërë në vazhdim të bashkëpunimit me Asociacionin e Komunave të Kosovës, po ashtu edhe në bashkëpunimin që Komuna e Prishtinës ka me komuna të veçanta nga vende të tjera. Takime me përfaqësues të BE-së, ICO, EULEX-it, Bankës Botërore, FMN-së, Komisionit Evropian, USAID-it, Sëisscontact etj., ku janë realizuar 27 takime.

## **II. MBLEDHJET E KUVENDIT, EKZEKUTIVIT DHE TRUPAVE PUNUESE**

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur:

- 12 mbledhje të Kuvendit,
- 12 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa,
- 16 mbledhje të rregullta të Këshillit të Drejtorëve,
- 12 mbledhje të Komitetit për Komunitete,
- 2 mbledhje të Komitetit për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim,
- 3 mbledhje të Komitetit për Arsim, Kulturë dhe Sport,
- 4 mbledhje të Komitetit për Pronë,
- 7 mbledhje të Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive,
- 5 mbledhje - tubim me qytetarë dhe debate për planifikimin e buxhetit.

## **III. AKTIVITETET E DREJTORIVE**

### **1. DREJTORIA E FINANCAVE DHE E PRONËS**

#### **a. Buxheti për vitin 2012**

Për vitin 2012, Komuna e Prishtinës ka pasur buxhet të miratuar prej 61,741,684 Euro. Nga këto mjete, të hyrat vetanake të planifikuara kanë qenë 21,752,189 Euro (apo 35% e buxhetit të përgjithshëm), realizimi i të cilave është rritur në 23,170,664 euro (apo për 1,418,475 euro, që është 7% më shumë krahasuar me planin). Pjesa tjetër e buxhetit prej 65%, vjen nga grantet qeveritare (granti i përgjithshëm, granti specifik për arsim dhe granti specifik për shëndetësi).

#### **b. Të hyrat vetanake**

Tabela në vijim paraqet burimet e të hyrave vetanake, të planifikuara dhe të realizuara. Nivel i arkëtimit të të hyrave është më i lartë për 7% në raport me planin. Në strukturën e të hyrave vetanake, pjesën më të madhe e përbëjnë të hyrat nga lejet e ndërtimit, me një rritje të konsiderueshme prej 55% krahasuar me vitin 2011. Krahasuar me vitin 2011, ngritje të konsiderueshme është shënuar edhe tek taksat kadasrale dhe gjoedezike, transaksioni i pronës, taksa për shërbime administrative të dokumenteve zyrtare, taksa për shërbime arsimore dhe taksa për automjete motorike.

Të hyrat nga tatimi në pronë, në vlerë absolute kanë qëndruar pothuajse njësoj me një vit më parë, por arkëtimi i tyre ka ngecur 12% nën planin. Vlerësojmë se kjo tregon gjendjen e vështirë sa i përket të ardhurave të familjeve, pasi papunësia mbetet shumë e lartë dhe të ardhurat reale kanë rënë dukshëm, si rezultat i inflacionit. Shporta ditore e shumë familjeve në Prishtinë është mjaft e varfër, dhe duket se kjo ka ardhur duke u përkeqësuar me rritjen e çmimeve të artikujve të tjerë. Prandaj, edhe arkëtimi i të hyrave nga tatimi në pronë nuk ka mundur të shënojë ngritje reale nga viti paraprak.

Tabela 2: Planifikimi dhe realizimi i të hyrat vetanake në vitin 2012

	Përshkrimi	2011			2012			Krahasimi i realizimit 2012/2011
		Planifikimi	Realizimi	% e realizimit	Planifikimi	Realizimi	% e realizimit	
1	Taksa për leje ndërtimi	10,200,922	8,952,261	88	11,412,189	13,856,426	121	155
2	Tatimi në pronën e paluajtshme	4,225,000	3,844,124	91	4,400,000	3,854,074	88	100
3	Taksa për leje pune	600,000	450,984	75	600,000	289,551	48	64
4	Taksa për shfryt. e sip. publike	1,150,000	1,260,608	110	1,200,000	1,187,243	99	94
5	Taksa nga kadastri dhe gjeod.	500,000	344,940	69	500,000	477,570	96	139
6	Taksa për transakcion në pron.	700,000	587,290	84	700,000	631,560	90	108
7	Të hyra nga inspekcioni	150,000	65,135	43	100,000	37,742	38	58
8	Taksa për cer. dhe dok. zyrtar.	200,000	235,742	118	220,000	239,017	109	101
9	Taksa për automjete motorike	350,000	441,250	126	380,000	453,440	119	103
10	Taksa për shërbime arsimore	850,000	1,130,123	133	980,000	1,144,944	117	101
11	Taksa për shërbime shëndetësore	200,000	195,215	98	200,000	192,941	96	99
12	Gjobat në trafik	900,000	723,874	80	800,000	287,361	36	38
13	Participime / Donacione	50,000	58,478	117	60,000	10,540	18	18
14	Të hyra tjera	50,000	99,044	198	200,000	142,917	71	144
15	Agjencia e Pyjeve	50,000	3,021	6	-	7,484	-	248
16	Gjobat nga gjykatat	-	477,056	-	-	357,854	-	75
	Gjithsej	20,175,922	18,869,145	94	21,752,189	23,170,664	107	123

Duhet theksuar se një pjesë e konsiderueshme e obligimeve të tatimit në pronë (rreth 20%) janë nga ndërmarrjet shoqërore, të cilat janë në proces të privatizimit dhe nuk janë të rregullta në pagesën e tatimit në pronë. Në vitet në vijim pritet të rriten dukshëm të hyrat nga ky tatim, si rezultat i përmirësimit të dukshëm të bazës së të dhënave të tatimit në pronë. Vetëm gjatë vitit 2012, janë regjistruar 5,200 prona të reja, shumica e të cilave janë njësi banimi në banesa kolektive që ende nuk janë të banuara, si dhe lokale afariste të reja që ende nuk janë në shfrytëzim. Një pjesë e tyre e regjistrimeve të reja janë objekte në ndërtim e sipër. Të gjitha këto prona të reja të regjistruara, pritet që të fillojnë pagesën e tatimit në pronë.

### c. Shpenzimet buxhetore

Shpenzimi i buxhetit për vitin 2012 ka arritur nivelin prej 80% në krahasim me mjetet e planifikuara për tu shpenzuar në këtë vit (tabela në vijim). Shpenzimi i buxhetit është realizuar sipas alokimit të mjeteve dhe rrjedhës së parasë së gatshme, duke përfshirë fondin burimor nga granti dhe të hyrat vetanake.

**Shpenzimet për paga dhe mëditje** janë realizuar tërësisht. Shkalla e realizimit të buxhetit në këtë kategori të shpenzimeve është më e lartë për 0.5%, për shkak të nevojave më të mëdha në arsim, krahasuar me planifikimin që ka bërë Ministria e Financave për pagat e arsimit.

**Shpenzimet për mallra dhe shërbime** janë realizuar pothuajse tërësisht (në nivelin 97%), sikurse edhe shpenzime komunale (97%). Duhet cekur se buxheti për shpenzimet

për mallra dhe shërbime dhe për shpenzime komunale, ka qenë i ulët krahasuar me nevojat e komunës, sepse është rritur numri i objekteve publike, si: shkolla, qendra të mjekësisë familjare, hapësira të gjelbëruara, ndriçimi publik etj., dhe kjo shtron nevojën për buxhet shtesë për mirëmbajtje të tyre. Në anën tjetër, edhe rritja e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve për shkak të inflacionit, ka shtruar nevojën që buxheti për këto kategori të jetë dukshëm më i lartë. Për shkak të kufizimeve të dhëna në kornizat buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave, në bazë të të cilave Komuna e përgatit buxhetin e saj, nuk ka qenë e mundur të parashihen më shumë shpenzime në këto kategori.

Tabela 3: Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2012

Programi	Buxheti i planifikuar		Buxheti i shpenzuar në euro	% e shpenzuar nga planifikim
	në euro	%		
Paga dhe mëditje	21,451,600*	34.72	21,565,850	100.53*
Mallra dhe shërbime	7,091,258	11.48	6,853,325	96.64
Shpenzime komunale	1,603,074	2.59	1,548,000	96.56
Subvencione dhe transfere	1,147,813	1.86	1,140,964	99.40
Investimet kapitale	30,482,839	49.34	18,125,320	59.46
Gjithsej	61,776,584	100.00	49,233,459	79.70

\*Mbulimi i minusit në programin e Arsimit për kategorinë e pagave në shumë prej 34.900 euro.

**Kategoria e subvencioneve** është shpenzuar tërësisht (99%), andaj nuk ka qenë e mundur të plotësohen nevojat e shumta për mbështetje të aktiviteteve kulturore, rinore e sportive, e sidomos sa i përket kërkesave për ndihmë sociale familjeve të varfra. Edhe pse familjet e varfra marrin asistencë sociale nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, ajo ndihmë duket se është shumë e vogël për të mbuluar sidomos nevojat në raste të sëmundjeve të ndryshme, që kërkojnë terapi të kushtueshme, të cilat nuk ofrohen nga Ministria e Shëndetësisë, e sa nga spitalet.

**Shpenzimet kapitale:** Pavarësisht përgatitjeve të bëra me kohë për fillimin e investimeve kapitale, krahasuar me planifikimet, shpenzimet në këtë kategori sillen rreth 60%. Menaxhmenti i Komunës ka qenë i angazhuar vazhdimisht në mbikëqyrjen e këtyre investimeve, përmes komisioneve mbikëqyrëse të parapara me ligjet përkatëse. Komisionet mbikëqyrëse janë mbledhur në baza të rregullta për të shqyrtuar dinamikën e projekteve, por, megjithatë, në shumë projekte ka pasur ngecje. Janë identifikuar disa arsye për këtë nivel të shpenzimeve kapitale.

Së pari, Kosova, si vend i ri dhe me një ekonomi të brishtë, vuan nga mungesa e kapaciteteve të firmave vendore për të ndërmarrë punë voluminoze dhe komplekse infrastrukturore. Ky problem manifestohet edhe në nivel kombëtar. Mungesa e kapaciteteve fizike dhe njerëzore të firmave (si mungesa e makinerisë së përsosur, e inxhinierëve me përvojë etj.), si dhe mungesa e likuiditetit të mjaftueshëm nga ana e kompanive të kontraktohen nga ana e Komunës, ka shkaktuar shumë vonesa në realizimin e projekteve.



Së dyti, Ligji i prokurimit publik i obligon të gjitha institucionet publike, përfshirë edhe Komunën e Prishtinës, të kontraktojë kompanitë që ofrojnë çmimin më të lirë. Kjo ka bërë që në disa raste ligji ka imponuar zgjedhjen e kompanive që nuk janë të përgjegjshme ekonomikisht dhe teknikisht për realizimin e projektit, por që vetëm kanë ofruar çmimin më të ulët. Me nënshkrimin e kontratës, është vërejtur se kompanitë e tilla nuk kanë likuiditet të mjaftueshëm për të bërë blerjet elementare për fillimin e punimeve.

Së treti, problemet pronësore kanë shkaktuar vonesa në shumë projekte. Edhe pse janë angazhuar të gjitha organet e Komunës, si Drejtoria e Financave dhe e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit, prapë shumë lëndë kanë mbetur të pazgjidhura, për shkak se të vonesave në trajtimin e lëndëve nëpër gjykata. Duket se edhe për një kohë, do të përballemi me problemet komplekse të shkaktuar nga vitet e administrimit të dhunshëm gjatë viteve të 1990-ta sa i përket pronave. Në shumë lokacione, nuk ka evidencë të saktë të pronarëve të pronave. Për shkak të mungesës së regjistrave autentik, për komunën është e vështirë të evidencojë saktë pronësinë e parcelave. Shumë qytetarë kanë pretendime të ndryshme për prona, të cilat pretendime duhet pritur derisa të zgjidhen në gjykatat kompetente. Në disa raste, janë filluar punimet në bazë të evidencës për pronën që ka Komuna, por janë paraqitur pengesa nga qytetarët që kanë pretendime për pronësi.

#### **d. Sektori për buxhet dhe financa**

Në bazë të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive dhe Ligjit për financat e pushtetit lokal, ky sektor ka përgatitur të gjitha raportet dhe pasqyrat financiare, kryerjen e pagesave sipas faturave, regjistrimin e të hyrave, barazimet me thesarin, ka punuar në përgatitjen e buxhetit për vitin 2013 dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve 2013 - 2015, ka bërë alokimin e vazhdueshëm të mjeteve sipas kërkesave të drejtorive etj.

#### **e. Sektori i tatimit në pronë të paluajtshme**

Aktualisht Komuna e Prishtinës ka 75,163 obligues tatimorë, prej tyre 64,460 janë obligues fizikë dhe 10,703 janë obligues tatimor juridikë. Në këtë vit, në bashkëpunim me USAID-in dhe LOGOS-in, si sponsorë, dhe Ministrinë e Financave dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës, si përkrahës, është bërë modifikimi apo rianketimi i 1/3 së objekteve të regjistruara dhe si rezultat janë bërë 5,200 regjistrime të reja. Janë bërë 3,350 përmirësime dhe modifikime, në kuadër të së cilës janë bërë verifikime të adresave, të numrit personal, korrigjimet e ndërrimit të destinimit, si dhe të zonave tatimore. Bordi i ankesave të tatimit në pronë të paluajtshme, ka pranuar 816 ankesa për tatimin në pronë. Prej tyre janë miratuar 675 kërkesa, ndërsa 141 janë refuzuar. Gjatë vitit është bërë vlerësimi i 218 banesave, 115 shtëpive, 25 lokale afariste, 4 garazheve dhe 875 paluajtshmërive të tjera.

Gjatë vitit 2012, ka ndryshuar Ligji i tatimit në pronë, i cili e ka rritur normën minimale të tatimit në pronë nga 0.05% në 0.15% të vlerës së patundshmërisë. Komuna ka nxjerrë rregulloren e re të tatimit në pronë, në përputhje me ligjin e ri. Për këtë qëllim është themeluar një komision, i cili ka punuar në ndryshimin e rregullores për tatimin në pronë,

në përputhje me ligjin për tatimin në pronë. Janë rivlerësuar patundshmëritë dhe janë zbatuar normat e reja të tatimit në pronë sipas ligjit. Rregullorja është miratuar nga Kuvendi i Komunës dhe është marrë pëlqimi nga ministritë përkatëse lidhur me të gjithë tatimpaguesit. Nga viti 2013 do të paguajnë tatimin në bazë të rregullores së re komunale për tatim në pronën e paluajtshme.

Gjatë vitit 2012, shërbimi për transaksionin në pronë ka proceduar 3,258 lëndë të transaksioneve financiare të pronave, bazuar në kontratat mbi shitje-blerje, të vërtetuara në gjykata apo noteri. Zyra e operatorëve me palë, në vitin 2012, ka pranuar 13,171 kërkesa nga tatimpaguesit, ndërsa prej tyre nga sistemi i tatimit në pronë janë lëshuar 11,981 certifikata të tatimit në pronë. 1,190 kërkesa janë refuzuar, pasi që palët nuk kanë kryer obligimet e parapara me ligj. Në emër të taksës për regjistrimin e automjeteve, në këtë vit janë regjistruar 44,454 automjete motorike. Këtu janë të përfshira të gjitha llojet e automjeteve, si dhe ato zyrtare. Përmes mediave të shkruara dhe elektronike, janë njoftuar të gjithë tatimpaguesit për afatin e pagesës së tatimit në pronë të paluajtshme. Në bazë të ligjit, për obliguesit tatimorë fizikë dhe juridikë që kanë borxh mbi 3,000 euro, janë dërguar letër kujtesa, bashkë me vërejtjen e fundit, përpara bllokimit të xhirrollogarisë bankare. Në kuadër të Zyrës së vlerësimit të pronës së paluajtshme, janë nxjerrë shënimet paraprake që nga viti 1975 deri në vitin 1998 dhe janë regjistruar në formën elektronike 29,980 obligues si tatimpagues të asaj periudhe.

#### **f. Sektori i pronës**

Në këtë sektor janë shqyrtuar kërkesat e personave fizikë dhe juridikë nga lëmi i rregullimit të marrëdhënieve pronësore–juridike lidhur me pronën komunale dhe pronën private, sipas planeve urbanistike. Një numër i konsiderueshëm i kërkesave ka qenë nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, për ndërtimin e infrastrukturës rrugore lidhur me shtrirjen e trasesë së rrugës. Me këtë rast janë shpronësuar 60 ngastra nëpër pjesë të ndryshme të qytetit, si në lagjen “Kalabria” ndërtimi i kolektorit atmosferik, ndërtimi i rrugës “B” në kuadër të Planit rregullues “Mati 1” dhe ndërtimi i rrugës “Enver Maloku” në kuadër të Planit rregullues “Mati 1”. Nga Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, janë bërë kërkesa për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e objekteve shkollore dhe atyre shëndetësore.

Gjatë këtij viti, në Sektorin e pronës janë drejtuar kërkesa nga institucionet qendrore për 28 raste. Janë bërë kërkesa për kompensimin e paluajtshmërive të pronarëve privatë, të cilat parcela, sipas planeve urbanistike, janë paraparë për hapësira publike. Një pjesë e këtyre kërkesave kanë mbetur pa u realizuar, për shkak të mundësive të vogla buxhetore. Në këto raste prioritet i është dhënë shpronësimit të atyre ngastrave, në të cilat veç ka filluar ndërtimi i rrugëve, kurse pjesët tjera të ngastrave do të shpronësohen gradualisht me realizimin e planeve urbanistike. Tek kërkesat për deeksprijim (kthimi i tokës ish-pronarëve), janë rekomanduar palët që t’u drejtohen organeve të gjyqësorit. Me miratimin e Ligjit për shit-blerjen e banesave për persona fizikë dhe juridikë, kanë arritur kërkesa prej 115 palëve për privatizimin e tyre. Me këtë rast, Këshilli i Drejtorëve ka marrë vendim për themelimin e komisionit prej 5 anëtarësh, të cilët do të kontribuojnë në shqyrtimin e këtyre kërkesave.

## **2. DREJTORIA E ARSIMIT**

Drejtoria e Arsimit, gjatë vitit 2012 ka zhvilluar aktivitet sipas planit të paraparë në ngritjen e cilësisë në procesin edukativo-arsimor dhe në përmirësimin e infrastrukturës moderne shkollore. Për këtë qëllim janë bërë investime kapitale, janë pranuar kuadro, në përputhje me nevojat dhe kufizimet financiare, janë realizuar aktivitete të ndryshme mësimore, kulturo-sportive, shënim i ngjarjeve të rëndësishme historike, kulturore dhe arsimore etj., si dhe është bërë monitorimi i procesit mësimor, për të krijuar një ambient sa më të sigurt në shkolla. Me përkrahjen e Bashkimit Evropian, është hartuar dhe miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, Plani zhvillimor i arsimit 2013-2017.

### **a. Të dhënat për institucionet arsimore dhe nxënësit**

**Arsimi parashkollor:** Gjatë vitit shkollor 2011/2012, veprimtarinë edukativo-arsimore e kanë zhvilluar 8 institucione parashkollore publike dhe një IP publiko-privat, me gjithsej 1,773 fëmijë të të gjitha grupmoshave. Po ashtu, veprojnë edhe dyzet (40) institucione parashkollore private. Prej tyre, vetëm 2 janë të licencuara, me 180 fëmijë prej 3-6 vjeç. Për IP tjera private mungojnë statistikat për numrin e fëmijëve.

**Arsimi fillore dhe i mesëm i ulët:** Gjatë vitit shkollor 2011/2012, veprimtarinë edukativo-arsimore e kanë zhvilluar 42 institucione arsimore publike, me gjithsej 34,262 nxënës, të organizuar në 1,417 paralele. Prej tyre, 23 nxënës të nacionalitetit boshnjak, 72 nxënës të nacionalitetit serb dhe 161 nxënës të nacionalitetit turk. Aktivitetin edukativo-arsimor e kanë zhvilluar edhe 8 institucione arsimore private, me gjithsej 1,207 nxënës. Në paralelet e arsimit parafillor, kanë qenë të regjistruar 2,071 nxënës, të sistemuar në 88 paralele. Ndërsa në klasën e parë kanë qenë të regjistruar 3,453 nxënës, të sistemuar në 143 paralele.

**Arsimi i mesëm i lartë:** Në vitin shkollor 2011/2012, veprimtaria edukativo-arsimore është zhvilluar në 12 institucione publike me 13,388 nxënës, të sistemuar në 402 paralele, prej tyre 16 nxënës të nacionalitetit boshnjak dhe 94 nxënës të nacionalitetit turk. Aktivitetin edukativo-arsimor e kanë zhvilluar edhe 9 institucione arsimore private, me gjithsej 1,129 nxënës.

Në të gjitha institucionet publike punojnë 3,177 mësimdhënës dhe personel tjetër teknik-administrativ dhe udhëheqës.

### **b. Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor**

Gjatë kësaj periudhe, zyrtarët arsimorë kanë realizuar 98 vizita informative, 23 vizita të përgjithshme, 29 vizita profesionale, 20 vizita speciale dhe 10 vizita kthyese. Zyrtarët e arsimit, gjatë realizimit të vizitave nëpër shkolla, kanë kontrolluar dokumentacionin pedagogjik, planprogramet mësimore, kanë monitoruar punën e mësimdhënësve sipas planit, kanë kontrolluar objektet shkollore dhe funksionalitetin e tyre, kanë përcjellë

shkallën e vijueshmërisë së nxënësve, mësimdhënësve dhe të punësuarve të tjerë nëpër shkolla. Kanë përcjellë shkallën e funksionimit të organeve profesionale dhe administrative të institucioneve shkollore, shkallën e bashkëpunimit me prindër, me institucionet tjera dhe shoqërinë civile. Ky shërbim ka analizuar vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve në mësim sipas periodave mësimore. Janë bërë vlerësimet dhe janë dhënë propozim-masat për përmirësime eventuale, sipas nevojës.

### **c. Ngritja e infrastrukturës shkollore gjatë vitit 2012**

Gjatë vitit 2012, janë lëshuar në punë disa objekte shkollore, anekse dhe salla të edukatës fizike dhe ka filluar ndërtimi i disa objekteve të tjera shkollore dhe objekteve të sportit. Me objektet e reja, të cilat janë inauguruar këtë vit shkollor, është shtuar hapësira mësimore për 20,235 m<sup>2</sup>. Në krahasim me vitin e kaluar, sa i përket hapësirës shkollore, gjendja është përmirësuar dukshëm në shkollat fillore dhe të mesme, pra nga 1.60 m<sup>2</sup> për kokë nxënësi sa ka qenë në vitin 2011, për këtë vit hapësira është rritur në 1.77 m<sup>2</sup> për kokë nxënësi. Kjo është një rritje për 11% të hapësirës për kokë nxënësi, me të cilën gjë është eliminuar ndërrimi i tretë në shkollat fillore dhe të mesme komunës.

Gjatë vitit 2012, është bërë inaugurimi i këtyre objekteve shkollore:

- Objekti i SHME “Hoxhë Kadri Prishtina”, me 4,735 m<sup>2</sup>, financuar nga Komuna;
- Objekti i SHMT “28 Nëntori”, me 5,800 m<sup>2</sup>, i financuar nga MASHT-i;
- Objekti i Gjimnazit Filologjik “Eqrem Çabej”, në lagjen “Çamëria”, me 5,800 m<sup>2</sup>, i financuar nga MASHT-i;
- Aneksi i SHF “Nexhmi Mustafa” në Besi, me 1,100 m<sup>2</sup>, i financuar nga CHF dhe Komuna;
- Aneksi i SHF “Meto Bajraktari”, me 1,100 m<sup>2</sup>, i financuar nga CHF dhe Komuna;
- Objekti i SHF “Filip Shiroka” në Slivovë – paralelja e ndarë fizike në Llajshec, me 480 m<sup>2</sup>, financuar nga Komuna;
- Salla e edukatës fizike e Gjimnazit “Xhevdet Doda”, me 640 m<sup>2</sup>, financuar nga Komuna.

Gjatë vitit 2012, janë ndërtuar:

- Terrene sportive në shkollat: “Pavarësia”, “Meto Bajraktari”, “Gjin Gazulli”, “Xhavit Ahmeti” dhe “Nazim Gafurri”.
- Në shkollën fillore “Nexhmi Mustafa” në Besi - PNF në Prugovc, është rregulluar oborri dhe terreni sportiv.
- Me mbështetje të “Swisscontact”, janë renovuar nyjat sanitare dhe kabinetet në shkollën e mesme “Shtjefën Gjeçovi”.

Ndërtimi i këtyre objekteve arsimore vazhdon në vitin 2013:

- Objekti i shkollës fillore në lagjen “Arbëria”,
- Objekti i shkollës fillore në Barilevë,
- Objekti i shkollës fillore “Emin Duraku”,
- Aneksi i shkollës fillore “Teuta” në Grashticë,
- Salla e edukatës fizike e shkollës fillore “Nazim Gafurri”,

- Salla e edukatës fizike e shkollës së re në Hajvali II,
- Me financim të MASHT-it, para tri viteve ka filluar ndërtimi i objektit të shkollës së mesme në lagjen “Kalabria” (te “Trafiku Urban”), por ende nuk është përfunduar.
- Në bashkëfinancim nga Banka Botërore, MASHT-i dhe Komuna, ka filluar ndërtimi i shkollës fillore te ish-Tjegullorja, si shkollë model. Në këtë projekt, Komuna ka ofruar lokacionin, ka ndërtuar nënkalimin për nxënës dhe ka bërë rregullimin e shtratit të përroit.

Janë bërë përgatitjet për fillimin e ndërtimit të Shkollës së Muzikës ‘Prenk Jakova’ që pritet të fillojnë punën në fillim të vitit 2013.

Meremetimi dhe rikonstruktimi i objekteve shkollore gjatë vitit 2012:

- Gëlqerosja e 12 objekteve shkollore, fasadimi i 2 objekteve shkollore, ndërrimi i dyerve, rikonstruktione të kulmeve në objektet e pesë shkollave dhe rregullimi i rrethojave;
- Pajisjen e shkollave me kabinete, inventar, libra, aparate fotokopjuese dhe pajisje të tjera;
- Instalime të reja dhe rikonstruktione të ngrohjes qendrore;
- Renovimi i institucioneve parashkollore në Hajvali dhe në institucionin parashkollor në Mat;
- Renovimi i nyjave sanitare në shkollat fillore “Elena Gjika” dhe “Iliria”, me bashkëfinancim Komuna/USAID-i;
- Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse (derivate të naftës dhe dru);
- Furnizimi i dhjetë (10) sallave të reja të edukatës fizike me vegla dhe rekuizita sportive.

#### **d. Aktivitetet e tjera të drejtorisë**

Janë organizuar “Garat e Diturisë”, “Garat e Matematicientëve” në kuadër të “Olimpiadës së Matematikës”, garat “Gjuhëtari i Ri” etj. Drejtorja e Arsimit ka bërë përgatitjet për organizimin e testeve kombëtare dhe ka bërë administrimin e testit të klasave të pesta, testit të maturës, si dhe testit të arritshmërisë për klasat e nënta. Drejtorja ka organizuar trajnime në bashkëpunim me MASHT-in dhe organizata tjera, si: Qendra e Arsimit të Kosovës (KEC), Komisioni Evropian, Organizata CESES, “Foundation Together Slovenia” dhe “Fondacion Together Kosova”, Qendra Rajonale për Mirëqenie Psiko-sociale të Fëmijëve, Klubi Kosovar për Energji dhe Mjedis, GIZ-i, “SWISS-CONTACT”, “Word Learning”, Banka Botërore, USAID - AED, BEP etj.

#### **e. Shërbimi i administratës**

Gjatë kësaj periudhe, janë përgatitur dhe shpallur konkurset për pranimin e kuadrove në shkolla, në të tri nivelet, si dhe konkurset për emërimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, që iu ka skaduar kontrata. Është bërë përgatitja e konkursit për pranim të nxënësve në shkollat e mesme të larta, i cili është shpallur nga Ministria e Arsimit, dhe konkursi për mësim joformal për shkollat profesionale.

### 3. DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Drejtoria ka qenë e angazhuar në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, duke ngritur kapacitetet njerëzore, zgjeruar rrjetin e institucioneve shëndetësore, forcimin e kapaciteteve diagnostikuese dhe shërbimeve emergjente para-spitalore, furnizimit më të mirë me barna etj.

#### a. Investimet dhe ngritja e kapaciteteve në shëndetësi

Gjatë vitit 2012, janë bërë investime të konsiderueshme në shëndetësi:

- Nga muaji gusht 2012, QMF në lagjen “Mati 1” ka filluar me ofrimin e shërbimeve shëndetësore për banorët e kësaj lagjeje, pasi më parë është bërë rregullimi i oborrit dhe rrethojës së kësaj QMF;
- Ka përfunduar ndërtimi i QMF IV, në rrugën “Bajram Bahtiri” (te Medreseja), me sipërfaqe 1,220 m<sup>2</sup>, e cila do të ofrojë shërbime të mjekësisë familjare, pediatrike, stomatologjike, të vaksinimit, laboratorike, si dhe, për herë të parë në këtë pjesë të qytetit, shërbimet e rëntgenologjisë. Është bërë edhe inventarizimi me inventar të nevojshëm, si dhe me pajisje mjekësore, por kjo QMF ende nuk është lëshuar në përdorim, për shkak të vonesave në rregullimin e oborrit dhe rrethojës, e cila pamundëson qasjen e personelit mjekësor dhe të pacientëve në objekt;
- Kanë përfunduar punimet në rregullimin e meskatit të QMFë në lagjen “Arbëria”.
- Ka përfunduar ndërtimi i objektit komemorativ, i cili i është dhënë në menaxhim NPK “Hortikultura”;
- Ka filluar ndërtimi i QMF në Besi dhe parashikohet që ndërtimi të kryhet brenda 3-mujorit të parë të vitit 2013, i cili ka sipërfaqe prej 800 m<sup>2</sup>, ku do të ofrohen shërbime të mjekësisë familjare, të stomatologjisë, vaksinimit, laboratorit, si dhe shërbime të tjera shëndetësore;
- Ka filluar ndërtimi i Ambulancës shëndetësore në Bardhosh, që pritet të përfundojë në 3-mujorin e parë të vitit 2013;
- Ka filluar ndërtimi i Ambulancës shëndetësore në Barilevë, pritet të përfundojë brenda 3-mujorit të parë të vitit 2013;
- Është blerë një aparat digjital i rëntgenit, për nevojat e QMF - IV;
- Është blerë një aparat i mamografisë, i cili është vendosur në QMF - V në lagjen “Dardania”, dhe për herë të parë do të fillohet edhe me shërbime të mamografisë në kuadër të KPSH-së;
- Janë blerë dy autoambulanca, për të përmirësuar shërbimin e transportit të pacientëve në hemodializë;
- Janë blerë pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së dhe QMU-së: një ultratingull 3D-4D për nevojat e QMG-së, 3 karrige stomatologjike, pajisje tjera për nevoja të laboratorit, si: aparate biokomike, hematologjike, pajisje për nevojat e stomatologjisë, pajisje manekine për trajnime në fushën e emergjencave etj.;
- Është bërë furnizimi/blerja e inventarit të nevojshëm për QMF IV, QMF në Besi, Ambulancën në Bardhosh, Ambulancën në Barilevë, si dhe inventar për nevoja të QMU-së dhe Qendrave Sociale;

- Janë pajisur 3 QPS me nga një automjet të ri për rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve cilësore sociale dhe familjare, si dhe një automjet për nevoja të ekipeve mjekësore në terren – pjesët rurale të qytetit;
- Janë bërë renovime dhe përmirësime në infrastrukturën e objekteve shëndetësore dhe sociale, si në shërbimin pediatrik të QKMF-së, në shërbimin e mjekësisë së punës në QKMF, nëpër ambulanca dhe qendra tjera mjekësore, instalimi / ndërtimi i një ashensori në objektin banesor kolektiv dedikuar familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së etj.;
- Dezinfektimi hapësinor i Prishtinës është realizuar në 4 faza, duke filluar në gjysmën e muajit qershor dhe ka përfunduar në gjysmën e dytë të muajit gusht. Secila fazë ka zgjatur nga 5 ditë, me intervale kohore ndërmjet fazave 21 ditë;
- Deratizimi vjeshtor i bodrumeve dhe garazheve publike në qytetin e Prishtinës është realizuar gjatë muajit shtator, dhe janë trajtuar rreth 102,250 m<sup>2</sup> sipërfaqe të bodrumeve dhe garazheve kolektive.
- Deratizimi vjeshtor i rrjetit të kanalizimit në qytetin e Prishtinës është realizuar gjatë shtatorit, janë trajtuar 4,832 puseta, me rreth 150 km rrjet të kanalizimit.
- Kanë përfunduar punët për rrethojën e oborrit të QMF-së në lagjen “Mati-1”.
- Ka përfunduar renovimi i hapësirave të QKMF, si: salla e trajnimeve dhe renovimi i katit të parë të QKMF-së, e cila tashmë edhe është funksionalizuar; Mjekësia e Punës në QKMF; janë realizuar edhe renovime dhe sanime të tjera, psh. në Ambulancën në Bardhosh, në Qendrën e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, në QMF - V në lagjen “Dardania” etj.

Përveç këtyre investimeve, janë ngritur kapacitetet e shërbimeve shëndetësore përmes:

- Hapjes së një pike të QMU-së në QMF-në në lagjen “Kodrën e Trimave”, që ka mundësuar reagim shumë më të shpejtë të ekipeve emergjente në rast nevojë në këtë pjesë të qytetit;
- Pajisja e laboratorit të QMU-së me një aparat të ri laborator;
- Pajisja e QMU-së me pajisje mjekësore për trajnimin e stafit;
- Funksionalizimi i shërbimeve laboratorike në QMF në lagjen “Vreshtat”;
- Zgjerimi i shërbimeve të radiologjisë në QMF - V, si dhe përgatitja për të filluar me këtë shërbim edhe në QMF IV;
- Fillimi i shërbimeve stomatologjike në QMF në lagjen “Arbëria”;
- Si shërbim i ri, për herë të parë në KPSH, do të jetë edhe mamografia, e cila do të fillojë të funksionojë në QMF V, ku është siguruar aparati i mamografisë;
- Përmirësimi i shërbimit të transportit të pacientëve të hemodializës, përmes blerjes së 2 autoambulancave të reja për këtë qëllim.

#### **b. Stafi i angazhuar në shërbimet shëndetësore**

Edhe gjatë vitit 2012, në komunën e Prishtinës shërbimet e mjekësisë familjare ofrohen me numër të njëjtë të të punësuarve, si edhe në vitin paraprak:

- 135 mjekë (100 specialistë të mjekësisë familjare dhe 35 mjekë të përgjithshëm);
- 63 specialistë (19 pediatër, 3 internistë, 8 dermatovenerologë, 8 gjinekologë, 9 specialistë të mjekësisë së punës, 3 biokimistë, 3 radiologë, 4 pneumoftiziologë

dhe nga 1 specialist i fushave të epidemiologjisë, higjienës, ORL, reumatolog, oftalmolog dhe një sociologe.

- 360 me kualifikim të mesëm shëndetësor (infermierë të përgjithshëm, laborantë dhe teknikë të radiologjisë).

Në shërbimin e stomatologjisë, shërbime profesionale stomatologjike ofrojnë 47 stomatologë dhe rreth 60 asistentë/teknikë të stomatologjisë. Në Qendrën e Mjekësisë Urgjente janë të punësuar 21 mjekë, prej tyre 2 specialistë të urgjencës, 2 internistë, 6 specialistë të mjekësisë familjare dhe 11 mjekë të përgjithshëm. Numri i infermierëve është 38. Shërbime të mirëqenies sociale në kuadër të Qendrave për Punës Social (QPS) në Komunën e Prishtinës ofrojnë 49 të punësuar.

### c. Të dhënat për shërbimet shëndetësore

Numri i përgjithshëm i shërbimeve shëndetësore të realizuara nga ana e QKMF-së gjatë vitit 2012, është rreth 1,864,540 vizita, që i bie më shumë se 5,000 shërbime shëndetësore brenda ditës.

Tabela 4: Raporti i shërbimeve shëndetësore për vitin 2012

Nr.	QMF	Vizita mjekësore	Shërbime tjera shëndetësore	Shërbime laboratorike	Shërbime radiologjike	Gjithsej
1	QKMF	225,392	157,964	199,692	0	583,048
2	QMF 1	50,941	43,777	62,675	0	157,393
3	QMF 2	35,925	30,485	22,468	0	88,878
4	QMF 3	29,567	18,785	46,448	0	94,800
5	QMF 5	120,688	67,177	66,827	0	254,692
6	QMF 6	59,253	27,844	24,937	0	112,034
7	QMF7	13,003	6,362	12,975	0	32,340
8	QMF8	6,401	3,840	0	0	10,241
9	QMF9	20,091	11,695	12,947	0	44,733
10	QMF10	14,468	8,575	0	0	23,043
11	QMF Hajvali	21,284	9,063	17,230	0	47,577
12	QMF Besi	13,129	9,536	14,686	0	37,351
13	QMF Mat	10,664	5,119	9,312	0	25,095
14	QMF Mat-1	2,376	957	0	0	3,333
15	Stomatologjia	57,008	57,478	0	0	114,486
16	Laboratori	64,266	62,675	0	0	126,941
17	Radiologjia	23,511	27,865	0	27,865	79,241
18	Ambulancat në fshatra	19,141	10,173	0	0	29,314
	Gjithsej	787,108	559,370	490,197	27,865	1,864,540

Në Qendrën e Mjekësisë Urgjente, gjatë këtij viti janë realizuar 36,916 shërbime shëndetësore (rreth 2% më shumë se në vitin paraprak). Prej tyre, 9,654 vizita mjekësore në terren, 11,345 vizita mjekësore në objektin e QMU, 3,633 shërbime të infermierisë dhe 81 shërbime reanimacioni. Numri i aksidenteve në komunikacion, në të cilat kanë ofruar ndihmën shërbimet e QMU-së gjatë vitit 2012, ishte 766, ndërsa fatkeqësi të tjera 1,051 raste.



Tabela 5: Raporti i shërbimeve shëndetësore të QMU-së për vitin 2012

	Vizita mjek. ne	Vizita mjek. ne QMU	Shërbime kirurgjike	Shërbime te reanimimit	Shërbime gjysmë - intensive	Shërbime te Infermierisë	Aksidente	Fatkeqësi	Shërbime laboratorike	EKG	Transporte	Konstatime vdekje	TOTAL
Janar	889	963	29	16	332	381	47	65	211	105	140	29	3,207
Shkurt	849	792	32	8	283	288	41	58	183	119	139	28	2,820
Mars	713	945	38	9	257	304	34	48	204	105	119	29	2,805
Prill	883	990	66	1	404	363	59	85	124	132	166	32	3,305
Maj	806	1,069	50	2	400	351	52	80	219	128	145	32	3,334
Qershor	829	943	60	15	343	283	79	91	145	97	155	26	3,066
Korrik	758	927	67	4	392	221	56	72	117	101	137	29	2,882
Gusht	795	1,033	84	1	420	309	90	99	146	122	159	11	3,269
Shtator	772	1,076	61	1	427	293	82	76	199	119	157	26	3,289
Tetor	782	968	43	10	322	262	77	234	193	110	183	35	3,219
Nëntor	734	907	49	2	273	310	81	70	172	124	152	27	2,901
Dhjetor	844	732	61	12	304	268	68	73	127	124	160	47	2,820
Gjithsej	9,654	11,345	640	81	4,157	3,633	766	1,051	2,040	1,386	1,812	351	36,916

#### d. Mirëqenia sociale

Çështja e banimit të grupeve vulnerable edhe këtë vit ka qenë ndër projektet madhore të Komunes së Prishtinës. Kështu, 50 familje të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së, këtë vit kanë përfituar banesa dhe janë vendosur në objektin banesor kolektiv të ndërtuar për këto raste, që gjendet te Fusha e Pajtitimit. Përveç kësaj, janë bërë të gjitha përgatitjet për ndërtimin edhe të 100 banesave tjera në vitin 2013, 50 prej të cilave do të ndahen për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së, dhe 50 të tjera për familjet në asistencë sociale.

Numri i përgjithshëm i familjeve shfrytëzuese të asistencës sociale gjatë vitit 2012, mesatarisht është rreth 2,560 familje në muaj. Krahasuar me vitin 2011, kur mesatarja mujore e familjeve në asistencë sociale ishte 2,773, në vitin 2012 ka një rënie, si rezultat i monitorimit më rigoroz të zbatimit të kriterëve për asistencë sociale, sidomos pas lidhjes së ATK-së (Administrata Tatimore e Kosovës) me databazën e shfrytëzuesve të asistencës sociale, ku një numër i caktuar i familjeve janë larguar nga asistencë sociale, pasi që janë gjetur se kanë realizuar të ardhura mujore nga burime të ndryshme.

Gjatë kësaj periudhe, ky sektor është përballur me një numër të madh të kërkesave për mbështetje financiare familjeve skamnore, për sigurimin e ushqimit, blerjen e barnave dhe për nevoja të tjera, të cilët janë përkrahur me medikamente dhe trajtim mjekësor, në shumë të përgjithshme rreth 100,000 Euro. Janë përkrahur edhe shumë projekte, në veçanti ato të OJQ-ve që punojnë në fushën e personave me aftësi të kufizuara.

Megjithatë, mjetet e alokuara për zbutjen e gjendjes së rëndë sociale janë të vogla për të mbuluar të gjitha kërkesat e familjeve në nevojë. Në vitin 2012, janë trajtuar 2,267 kërkesa. Shumica e tyre janë për ndihmë emergjente sociale (1,356 prej tyre), pastaj për banim dhe strehim social 95 kërkesa, për barna dhe kurim mjekësor 77, e kështu me

radhë. 349 kërkesa kanë qenë për marrje të formularit për aplikim në MSH për trajtim mjekësor jashtë vendit.

Tabela 6: Numri i familjeve në asistencë sociale, sipas QPS, gjatë muajve të vitit 2012

Muaji	QPS “Qendra”	QPS “Kodra e Trimave”	QPS “Kodra e Diellit”	Totali
Janar	700	1,286	700	2686
Shkurt	695	1,331	719	2745
Mars	705	1,314	711	2730
Prill	700	1,321	707	2728
Maj	698	1,296	710	2704
Qershor	636	1,301	623	2560
Korrik	634	1,329	626	2589
Gusht	636	1,320	618	2574
Shtator	610	1,312	596	2518
Tetor	528	1,286	469	2283
Nëntor	512	1,283	485	2280
Dhjetor	524	1,291	509	2324
Mesatarja vjetore	632	1306	623	2560

Ky sektor ka kryer edhe këto punë dhe detyra: monitorimin dhe koordinimin e punës së QPS-ve, përkujdesjen ndaj familjeve të strehuara në lagjen ”Fusha e Pajtimit”, menaxhimin e punëve me rastin e ndarjes së ndihmave nga donatorët e ndryshëm dhe përzgjedhjen e përfituesve në koordinim me QPS, si dhe kryerjen e detyrave tjera të përditshme. Është bërë monitorimi dhe është dhënë ndihmesa QPS-ve gjatë përzgjedhjes së familjeve për asistencë sociale. Në bashkëpunim me nxënësit e gjimnazit “Sami Frashëri”, për festat e fundvitit janë siguruar pako familjare ushqimore, në vlerë prej rreth 50 Euro, për 60 familje në asistencë sociale, ndërsa në bashkëpunim me PTK-në, janë siguruar dhurata për festën e Vitit të Ri për 100 fëmijë të familjeve në asistencë sociale.

#### e. Ngritja e kapaciteteve njerëzore në shëndetësi

Në vitin 2012 janë mbajtur 19 takime profesionale, ku kanë marrë pjesë mesatarisht 42 mjekë familjarë. Në bashkëpunim me OBSH, për zbatimin dhe monitorimin e standardeve për rritjen e shëndoshtë të fëmijëve të moshës 0-5 vjeç, ka vazhduar zbatimi i këtij projekti (i filluar vitin paraprak) në të gjitha QMF-të. Kujdes i është kushtuar zbatimit të kriterëve për përshkrimin e antibiotikëve parenteralë nga ana e mjekëve familjarë. Në vazhdimësi është duke u zvogëluar edhe shkalla e referimit të pacientëve nga KPSH në QKUK, një indikator ky i fuqizimit të mjekut familjar në trajtimin e pacientëve. Në tetor është organizuar Konferenca Ndërkombëtare e Mjekësisë Familjare, me temën “Kujdesi parësor shëndetësor – Reformat e sistemit shëndetësor”, në patronatin e Kryetarit të Komunë, dhe në bashkëpunim me Asociacionin e Mjekëve Familjarë të Kosovës (AMFK). Në konferencë kanë marrë pjesë mbi 500 mjekë nga Kosova dhe nga vendet tjera, si: SHBA-ja, Anglia, Turqia, Sllovenia, Shqipëria, Mali i Zi, Kroacia, Maqedonia, etj.

Gjatë muajit nëntor, një grup prej 8 mjekëve dhe infermierëve të QKMF-ve dhe QMU-ve, realizoi një vizitë studimore në Suedi, ku për së afërmi u njoftuan me organizimin e

mjekësisë familjare, shërbimet e emergjencës dhe politikat e zhvillimit të mjekësisë familjare në këtë vend. Janë organizuar një sërë trajnimesh dhe seminaresh në QMU nga ekspertë vendorë dhe të jashtëm, si trajnimi për ACLS (Përkrahja e Avancuar për Jetë Kardiovaskulare) dhe ligjërata dhe trajnime në modulën PALS (Përkrahja e Avancuar Pediatrike). Janë mbajtur edhe trajnime për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve emergjente nga zyra e OBSH-së në Prishtinë. Dy ekipe mjekësore të QMU-së kanë marrë pjesë në ushtrimin fushor të mbajtur në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, lidhur me fatkeqësitë me viktimë nga rrëzimi i një aeroplani, të organizuar nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave. Një ekip i QMU-së ka qëndruar në Suedi, për të marrë pjesë në “Ushtrimin internacional për menaxhimin e fatkeqësive”, një tjetër në Zagreb në “Ushtrimin internacional fushor për menaxhimin e katastrofave dhe fatkeqësive natyrore” etj. Janë mbajtur disa ligjërata nga ekspertë vendorë, me tema të ndryshme si: “Sindromi akut koronar në emergjencat paraspitalore”, “Rekomandimet e reja për RKP nga Komiteti Evropian i Reanimacionit”, “Asthma Bronchiale në Shërbimin e Emergjencës” etj.

#### **f. Furnizimi me barna dhe material shpenzues**

Gjatë vitit 2012, është shënuar arritje e madhe në ngritjen e kapaciteteve planifikuese të barnave dhe materialit tjetër mjekësor shpenzues nga ana e QMF-së. Është ngritur një sistem i brendshëm i monitorimit dhe analizimit të sasisë së barnave dhe materialit tjetër shpenzues të planifikuar, sasisë së kërkuar dhe sasisë së furnizuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Sidoqoftë, edhe më tutje furnizimi me barna dhe material shpenzues nga ana e MSH-së, edhe pse i përmirësuar këtë vit, mbetet larg plotësimit të nevojave dhe kërkesave të pacientëve të kryeqytetit.

### **4. DREJTORIA E EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT**

#### **a. Sektori i ekonomisë**

Në sektorin e transportit të udhëtarëve me auto-taksi janë bërë ndryshime cilësore dhe vizuale, duke zbatuar rregulloren mbi këtë lloj transporti, ku qytetarëve u është ofruar siguri, si dhe transparencë lidhur me shfrytëzimin e këtij lloji shërbimi, me vendosjen e shenjave identifikuese mbi auto-vetura. Në vazhden e projekteve për zvogëlimin e papunësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit, në bashkëpunim me Zyrën Regjionale të Punësimit, ka realizuar projektin “Trajnimi i të rinjve në punë në ndërmarrësi”, ku 30 të rinj të papunë janë trajnuar direkt në punë, dhe për këtë janë kompensuar me nga 130 € në muaj. Projekti ka zgjatur 6 muaj.

Komuna e Prishtinës është përfutuese e projektit “One Stop Shop”, projekt ky i rëndësishëm për komunitetin e biznesit, ku janë trajnuar mbi 450 biznese ekzistuese dhe fillestare. Njëkohësisht, është bërë edhe trajnimi i stafit nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit për regjistrimin e bizneseve, sepse pritet delegimi i kompetencave nga MTI-ja, gjegjësisht Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Komunë.

## **b. Sektori për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural**

Janë realizuar të gjitha projektet e parapara, me përjashtim të projektit “Bashkëfinancim me donatorë” si rezultat i vonësive të procesimit nga ana e bashkëfinancuesit dhe pritjet të realizohet në vitin vijues. Komuna ka ndarë 438,233 euro subvencione:

• Përkrahja e fermerëve për mbjelljen e patates	49.894,00
• Përkrahja e fermerëve në lëmin e perimtarisë - serra	38.424,00
• Vaksinimi i gjedheve dhe qenve shtëpiakë dhe mbarësimi artificial i gjedheve	26.000,00
• Përkrahja e fermerëve në lëmin e shpesërisë - pulave vojse	24.000,00
• Përkrahja e fermerëve në blegtori	49.920,00
• Furnizimi me bletë dhe pajisje bletare	47.120,00
• Meliorimi i livadheve dhe kullosave në Rajonin e Gollakut	49.950,00
• Përkrahja e fermerëve për mbjelljen e grurit	100.000,00
• Trajnimi i të rinjve në punë	23.400,00

**Realizimi i mbjelljeve pranverore:** Janë mbjellë 1,136 ha me kultura pranverore: tërshërë 48 ha, misër 630 ha, bimë foragjere 35 ha, patate 218 ha, perime 53 ha, fasule si monokulturë 19 ha, elb pranveror 23 ha. Me qëllim të përkrahjes së fermerëve për mbjellje pranverore, si dhe stimulimin e fermerëve për rritjen e sipërfaqeve me kultura pranverore, Komuna e Prishtinës ka bërë subvencionimin e disa kategorive të fermerëve.

**Përkrahja e fermerëve për mbjelljen e patates:** Janë subvencionuar fermerët për mbjelljet pranverore me patate, ku kanë përfituar 66 fermerë, sipas kategorive:

a) Kategoria I	494.00€ ( 2 ha patate)
b) Kategoria II	741.00€ ( 3 ha patate)
c) Kategoria III	988.00€ ( 4 ha patate)
d) Kategoria IV	1,235.00€ (5 ha patate)

**Furnizimi me serra:** Me këtë projekt janë përkrahur 300 fermerë, me nga një serrë, në sipërfaqe prej 54 m<sup>2</sup>.

**Veterina mobile:** Me qëllim të parandalimit të sëmundjeve infektive, është bërë vaksinimi i 4,158 gjedheve dhe 634 qenve, si dhe mbarësimi artificial i 945 gjedheve.

**Përkrahja e fermerëve në lëmin e shpesërisë - pula vojse:** Janë përkrahur gjithsej 4 fermerë komercialë për gjithsej 14 000 pula vojse me ushqim të koncentruar, në sasi prej 79 940 kg ushqim të koncentruar.

**Përkrahja në lëmin e blegtorisë:** Janë përkrahur fermerët që kanë pasur 4 -10 krerë (gjedhe qumështore) me nga 40 € / krerë. Kanë përfituar gjithsej 172 fermerë, me numër të përgjithshëm prej 1 248 krerë (gjedhe qumështore).

**Furnizimi me pajisje bletare:** Pajisje bletare kanë përfituar 40 bletarë, ndërsa nga dy bletë kanë përfituar gjithsej 140 bletarë.

**Meliorimi i livadheve dhe kullosave:** Me qëllim të sigurimit të ushqimit foragjer cilësor për kafshë, është bërë furnizimi i fermerëve me farë bari dhe pleh mineral, gjithsej janë përkrahur 258 fermerë me nga 200 kg pleh NPK dhe 30 kg farë bari.

**Analiza e tokës bujqësore:** Qëllimi i këtij projekti ka qenë përcaktimi i pjellorisë së tokës bujqësore, përkatësisht nevojave të bimëve për materie ushqyese - plehra. Për këtë qëllim janë analizuar gjithsej 2000 mostra dhe rezultatet e fituara na kanë dhënë një pasqyrë të saktë për nevojat e tokës për elemente ushqyese.

**Realizimi i mbjelljeve vjeshtore:** Procesi i mbjelljeve është realizuar sipas planifikimeve. Kushtet klimatike kanë qenë të volitshme për mbjelljen e kulturave vjeshtore. Në bazë të të dhënave që janë siguruar, në këtë vit janë mbjellë gjithsej 1,057 ha: me grurë 1,035 ha dhe me bimë foragjere 25 ha.

**Përkrahja e fermerëve për mbjelljen e grurit:** Me qëllim të subvencionimit të fermerëve për mbjelljet vjeshtore, Komuna e Prishtinës ka ndarë 100.000,00 €, nga e cila shumë kanë përfituar gjithsej 509 fermerë, me një sipërfaqe të përgjithshme 895.5 ha, ku secili fermer ka përfituar nga 111 €/ha. Përfitues kanë qenë fermerët me sipërfaqe të mbjellë prej 1- 2 ha.

**Këshillime profesionale të fermerëve:** Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është realizuar projekti “ Dhënia e këshillave fermerëve “ me që rast u janë dhënë këshilla fermerëve të tri kategorive: fermerëve ekzistencial, fermerëve gjysmë komercial dhe fermerëve komercial.

**Procesi i korrje-shirjes:** Procesi i korrje-shirjes ka filluar më 06.07.2012 dhe ka përfunduar me 27.07.2012. Kanë marrë pjesë autokombajna që kanë përfituar subvencione në derivate të naftës, në sasi prej 1,050 litra për autokombajnë. Çmimi i korrjes sillej rreth 100 €/ha, pa lidhëse, pasi MBPZHR ka bërë subvencionimin në derivate të naftës, prandaj edhe është arritur marrëveshja në mes MBPZHR-së, komunave dhe auto-kombajnerëve që të respektohet çmimi i lartpërmendur. Sipërfaqet e përgjithshme të mbjella me drithëra të bardha kanë qenë 1,416 ha, prej tyre: grurë 1,345ha, tërshërë 48ha dhe elb 23 ha. Rendimentet dhe cilësia ishin të mira dhe silleshin mesatarisht: grurë 4, 100kg/ha, elb 3, 300 kg/ha dhe tërshërë 2,900 kg/ha.

### c. Shërbimi i pylltarisë

Janë realizuar këto aktivitete në lëmin e pylltarisë dhe gjuetisë: mbrojtja dhe ruajtja e pyjeve nga prerjet ilegale, mbrojtja nga zjarri, mbjellja e sipërfaqeve të zhveshura në vendin e quajtur “FLUR” në Prapashticë, në sipërfaqe prej 16 ha, pastrimi i pyjeve publike, në bashkëpunim me APK-në dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies sociale, në sipërfaqe prej 81 ha dhe rrallimi para tregtar në sipërfaqe prej 48.5 ha. Janë konfiskuar masë drusore ilegale në sasi prej 75.81 m<sup>3</sup>. Me këtë masë drunore dhe me ato të bartura nga viti paraprak prej 79.00 m<sup>3</sup>, janë përkrahur familje në asistencë sociale me 120.18 75,81 m<sup>3</sup>, ndërsa pjesa e mbetur gjendet në depo. Janë trajtuar 189 kërkesa për leje për prerje të pyjeve dhe janë lëshuar 172 leje për prerjen e 18,742.53 m<sup>3</sup> dru. Janë lëshuar 64

fletëparaqitje penale dhe 30 kundërvajtje për prerësit ilegal të pyjeve, të cilët i kanë dëmtuar pyjet në sasi prej 537.67 m<sup>3</sup>.

Në këtë vit ka filluar zbatimimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës për caktimin e vendgjuetive të përbashkëta dhe dhënien e tyre në menaxhim. Bazuar në këtë vendim, janë dhënë në shfrytëzim vendgjuetitë: “Prishtina I” me sipërfaqe të përgjithshme prej 6.349,02 ha, “Prishtina II”, me sipërfaqe të përgjithshme prej 7.243,52 ha, dhe “Prishtina III”, me sipërfaqe të përgjithshme prej 12.578,40 ha. Menaxhimin me këto vendgjueti e bëjnë tri shoqata të gjuetarëve, të cilat veprojnë në territorin e komunës së Prishtinës, dhe si rezultat i këtij menaxhimi edhe mbikëqyrjes nga ana e Sektorit të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, ka përmirësim të gjendjes në fushën e gjuetisë.

## 5. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në Drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUNMM) kanë arritur gjithsejtë 1,724 kërkesa, kurse nga viti paraprak janë bartur edhe 277 kërkesa, gjithsej 2,001 kërkesa. Prej tyre janë shqyrtuar 1,781 kërkesa:

• Numri i përgjithshëm i kërkesave për punë	2,001
• Të bartura nga viti paraprak	277
• Numri i kërkesave të arritura 2012	1,724
• Të shqyrtuara	1,781
• Numri i Lejeve Urbanistike	237
• Numri i Lejeve të Ndërtimit	208
• Refuzime	155
• Pëlqim në projekt kryesor dhe aktvendime	205
• Informime	707
• Njoftime	29
• Leje paraprake	7
• Konkluzë	34
• Leje rrënimi	3
• Aktvendime për komisione	51
• Leje përdorimi	9
• Të miratuara (si caktimi i pikave etj.)	136
• Në procedurë	220

Përveç këtyre, janë shqyrtuar edhe 2,093 lëndë të pranuar më herët lidhur me procedurën e legalizimit.

### a. Sektori i urbanizmit

Sektori i Urbanizmit është marrë me shqyrtimin e kërkesave të ndryshme të qytetarëve të Prishtinës, investitorëve vendorë dhe të huaj, institucioneve qendrore dhe lokale, shoqatave të ndryshme etj. Ky sektor gjatë shqyrtimit të kërkesave, njëkohësisht bën edhe zbatimin e planeve rregulluese të miratuara nga Kuvendi i Komunës. Në proces të shqyrtimit të zgjidhjeve urbane, duke ndërmjetësuar në harmonizimin e kërkesave të

investitorëve të ndryshëm me kriteret e planeve rregulluese. Sektori i urbanizmit gjatë procedurës së shqyrtimit të lëndëve, ka lëshuar aktvendime për caktimin e kushteve të lokacionit, caktimin e kushteve ndërtimore, kompensimin e rregullimit të tokës ndërtimore, leje ndërtimore, leje paraprahe, leje për rrënimin e objekteve, konkluzione për miratimin e projekteve urbo-arkitektonike dhe atyre ideore për zona përkatëse.

### **b. Sektori i planifikimit**

Në bazë të detyrave programore, prioritet i veçantë i është dhënë hartimit të planeve rregulluese, ku janë mbajtur punëtori me kompanitë të cilat janë angazhuar për hartimin e këtyre projekteve. Në pajtim me dispozitat ligjore, janë organizuar edhe takime me qytetarë.

Në bazë të detyrave projektuese, në hartim e sipër janë këto plane urbane:

- Plani zhvillimor komunal,
- Plani zhvillimor urban,
- Prishtina e Re, me tri zona:
  - o Zona perëndimore,
  - o Zona qendrore dhe
  - o Zona lindore.
- Plani rregullues “Mati 2”
- Plani rregullues “Kodra e Trimave 1”

Është hartuar detyra projektuese për plotësimin dhe ndryshimin e Planit rregullues për lagjet: “Kalabria”, “Sofalia”, “Lakërishta” dhe “Arbëria 3”. Tani këto plane janë në fazën e tenderimit.

### **c. Sektori i ndërtimit**

Ky sektor, në bazë të detyrave programore, kryesisht është marrë me përpunimin e lëndëve me problematikë të ndërtimit, hartimin e detyrave projektuese, mbikëqyrjen e objekteve, formimin e komisioneve profesionale, caktimin e komisioneve për pranimin teknik të objekteve, dhënien e lejeve për përdorim të objekteve, si dhe veprimtari të tjera që kanë të bëjnë me këtë sektor. Sektor i ndërtimit gjatë kësaj periudhe raportuese gjithashtu ka bërë mbikëqyrjen e projektimit dhe ndërtimit të të gjitha objekteve të larta dhe të ulëta, në të cilat ka investuar Komuna, në të gjitha drejtoritë, si: shkollat, rrugët, qendrat e mjekësisë familjare, kanalizimet etj. Gjithashtu, ky sektor ka përgatitur 51 vendime për komisione për pranim teknik të objekteve dhe punimeve që i ka financuar Komuna dhe të objekteve private, si dhe ka lëshuar 6 leje të përdorimit.

### **d. Sektori i mbrojtjes së mjedisit**

Sektori i mbrojtjes së mjedisit ka bërë njoftime në lidhje me mbrojtjen e ambientit (tokës, ujit dhe ajrit) siç janë: kontrollimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, trotualet, ujërat e zeza, si dhe zhurmat e shkaktuara nëpër lokale afariste dhe nga gjeneratorët. Në bashkëpunim me programin “TRACE” të Bankës Botërore, është bërë studimi i fizibilitetit në disa sektorë, siç janë: trafiku, efienca e energjisë, mbrojtja e mjedisit etj. Me USAID-in është

përfunduar “Planin investiv për ujësjellës dhe kanalizim”. Po ashtu, në bashkëpunim me GIZ-in, ka filluar pilot projekti në lagjen “Dardania” për ndarjen e mbeturinave, si dhe fushatën për vetëdijësimin e nxënësve dhe qytetarëve të kësaj lagje. Me aktivitete të ndryshme janë shënuar disa data, si: Dita Botërore e Ujërave (22.03.2012), Dita Botërore e Tokës (22.04.2012 ) dhe Dita Botërore e Mjedisit (05.2012). Më 24.05.2012 është bërë organizimi për pastrimin e komunës së Prishtinës, në kuadër të iniciativës “Ta pastrojmë Kosovën”. Janë mbajtur dhe trajnime të ndryshme të stafit nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, në aspektin e dhënies së lejeve mjedisore komunale. Po ashtu, është përgatitur detyra projektuese për Vlerësimin strategjik mjedisor të Planit zhvillimor urban dhe Planit zhvillimor komunal. Gjatë kësaj periudhe kanë filluar të lëshohen edhe lejet mjedisore komunale dhe zbatimi i Rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

#### **e. Sektori i legalizimit**

Ky sektor ka vazhduar punën në trajtimin e kërkesave për legalizim të objekteve pa leje të ndërtimit, që janë pranuar gjatë periudhës së aplikimit në vitin 2010, që gjithsej kanë qenë 6,158. Gjatë kësaj periudhe, janë lëshuar 75 leje të legalizimit për objekte të ndërtuara pa leje, janë caktuar 167 kushte urbanistiko - teknike për hartimin e dokumentacionit - projekte për objektet e zbatuara, me elaboratet përkatëse, të cilat janë në procedurën e dhënies së pëlqimit përkatës. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve, janë refuzuar 5 kërkesa, të cilat kryesisht janë rastet që janë bërë ndërtime në hapësira publike dhe në korridore të rrugëve të planifikuara. Po ashtu, në 1,873 raste janë lëshuar kërkesa për plotësimin e lëndëve (bashkëpronësi, pa dokumente), konkluzione për pezullimin e përhoshëm të procedurës etj. Me kërkesë të palëve, janë lëshuar 11 informata, lidhur me informimin se gjenden në regjistrin e lëndëve që kanë aplikuar për legalizim. Janë lëshuar edhe 86 vërejtje - urgjenca për kompletim të dokumentacionit teknik, në rastet kur është tejkaluar afati i paraparë me ligj. Numri i përgjithshëm i lendeve të trajtuara është 2,093. Ekspertët e këtij sektori kanë marrë pjesë në komisione të caktuara profesionale për menaxhim dhe mbikëqyrje të projekteve, për pranime teknike etj., në bashkëpunim me ekspertët tjerë të drejtorive tjera përkatëse komunale.

### **6. DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS LOKALE**

Drejtorja e Infrastrukturës Lokale (DIL) ka kryer këto aktivitete: hartimin e detyrave projektuese dhe identifikimin e nevojave, shqyrtimin e kërkesave të banorëve të bashkësive lokale dhe inkuorporimin e tyre në planet e komunës, njoftimin me kohë të kompanive publike dhe subjekteve relevante, me qëllim të koordinimit të punëve, incizimin e gjendjes ekzistuese të infrastrukturës në qytetin e Prishtinës, hartimin e paramasave dhe parallogarite, si dhe kompletimin e dokumentacionit teknik për procedimin e tyre në organet kompetente, mbikëqyrjen e realizimit të projekteve konform marrëveshjes etj.

Gjatë vitit 2012, Drejtorja ka proceduar kërkesat e bashkësive lokale dhe banorëve: për ndërtimin e rrugëve, trotuareve dhe kanalizimeve, kërkesa për rregullimin e rrugëve dhe kanalizimeve, kërkesa nga kompanitë publike - leje për gropim dhe intervenime për



sanimin e defekteve të ndryshme, kërkesa nga kompanitë për formime të komisioneve për kontrollimin e punëve, kërkesa të natyrave të ndryshme rreth definimit të zgjidhjes në terren etj.

#### a. Vëllimi financiar dhe fizik i projekteve të realizuara

Në vitin 2012, vëllimi fizik i projekteve të realizuara ka qenë si në vijim:

- Rrugë të ndërtuara me asfalt dhe pllaka 35,911.93 metra gjatësi,
- Sipërfaqe të asfaltuara 469,977.76 metra katrorë,
- Trotuare 17,506.50 metra katrorë,
- Sipërfaqe të ndërtuara me pllaka 83,761.90 metra katrorë,
- Kanalizime fekale 17,258.00 metra gjatësi,
- Kanalizime atmosferike 4,450.00 metra gjatësi,
- Rrjeti i ujësjellësit 4,022.00 metra gjatësi.

#### b. Projektet infrastrukturore të bartura nga viti 2011

Tabela në vijim paraqet projektet infrastrukturore, në të cilat është punuar gjatë vitit 2012, por që janë bartur nga viti 2011.

Tabela 7: Projektet infrastrukturore të bartura nga vitit 2011

Nr	Emri i projektit	Vlera e kontraktuar	Statusi
1.	Rindërtimi i rr. Lidhëse me rr. "Vëllezërit Fazliu" dhe "Isa Kastrati	286,645.10	I përfunduar
2.	Ndërtimi i rrugës " Ekrem Rexha "	771,266.36	I përfunduar
3.	Ndërtimi i rrugës " Ibrahim Fehmiu "	939,190.86	I përfunduar
4.	Asfaltimi i rrugës ne lagjen " Kaqot " nëKeqekolle	244,239.05	I përfunduar
5.	Asfaltimi i rrugëve Sunidoll - Bernicë (faza e pare)	286,928.50	I përfunduar
6.	Ndërtimi i rrugës Qemal Stafa	870,000.54	I përfunduar
7.	Ndërtimi i mureve mbrojtëse në rrugën Tomori, Tutini 27 Nentori , Keqekolle - Kaqot	126,365.20	I përfunduar
8.	Ndërtimi i rrugës Viti Bullaj	187,814.00	I përfunduar
9.	Ndërtimi i rrugëve Flotacion - Lagja Vrajolle	519,882.73	I përfunduar
10.	Ndërtimi i rrugës " Tahir Zajmi "	967,101.10	I përfunduar
11.	Rregullimi i kolektorit nga rruga " Abedin Rexha deri te rruga " Ibrahim	350,699.80	I përfunduar
12.	Zgjerimi i rrugës përbri Ambasadës amerikane	69,769.11	I përfunduar
13.	Ndërtimi i kanalizimit dhe ujesjellsit ne rrugët "Haxhi Zeka dhe Ndue	181,452.67	I Pa Përfunduar
14.	Ndërtimi i vazhdimit të rrugës Enver Maloku (2010)	1.368.616,82	I Pa Përfunduar
15.	Ndërtimi i rrugës Paralele Shkup (2010)	1,348,928.50	I Pa Përfunduar
16.	Rindërtimi i rr. "Ndue Perlleshi" nga rr. "Muharem Fejza deri te qendra e mjekësisë familjare Mati 1	142,191.91	I Pa Përfunduar
17.	Ndërtimi i rruges " B "	2,883,847.12	I Pa Përfunduar
18.	Ndërtimi i rruges "B" faza e katert	1,141,021.30	I Pa Përfunduar
	Ndërtimi i rr. "Ahmet Krasniqi "	986,957.34	I Pa Përfunduar
19.	Ndërtimi i rrugës ne Mramor - lagja Spahiaj	454,624.00	I Pa Përfunduar
20.	Sanimi i disa rrugëve ne qytet dhe fshatra neK.prishtines	287,871.62	I Pa Përfunduar
21.	Rindërtimi i disa rrugëve ne lagjen Arberia ,Velani dhe Sofali	381,615.80	I Pa Përfunduar
22.	Rregullimi i kolektorit ne proin Vellusha ne Taukbahçe	277,947.55	I Pa Përfunduar

### c. Projektet infrastrukturore të kontraktuara në vitin 2012

Tabela në vijim paraqet projektet infrastrukturore të kontraktuara në vitin 2012.

Tabela 8: Projektet infrastrukturore të kontraktuara në vitin 2012

1	Ndërtimi i “Sheshit të Pavarësisë - Ibrahim Rugova”, punimet janë në realizim e sipër.
2	Ndërtimi i sheshit “Zahir Pajaziti” - Punimet janë në realizim e sipër.
3	Ndërtimi i rrugës mbi kolektorin atmosferik të lumit Prishtina, në lagjen “Kalabria” - rruga mbi kolektor në tërësi është asfaltuar me bituzhavorr, ndërsa në pjesën e trotuarit është duke u realizuar rrjeti i ujësllësit me anë të tubave të prodhimit sipas EU-së.
4	Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik nga rruga " Bill Klinton”, përreth Doganës deri te Ambasada amerikane në l. “Arbëria” si dhe rindërtimi i rrugës në drejtim të rrethrotullimit në lagjen “Lakërishta” - të gjitha punimet në tërësi janë kryer dhe është bërë pranimi teknik.
5	Rindërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve në rrugën lidhëse “Hasan Remniku” - “Haxhi Zeka” dhe rrugët “Dervish Cara “ dhe “Enver Berisha” - të gjitha punimet në tërësi janë kryer dhe është bërë pranimi teknik
6	Rindërtimi i rrugëve lidhëse në Hajvali dhe Mramor - të gjitha punimet në tërësi janë kryer, pritet të bëhet pranimi teknik dhe pagesa përfundimtare
7	Asfaltimi i rrugëve në Shkabaj dhe Rimanishtë - të gjitha punimet në tërësi janë kryer dhe është bërë pranimi teknik
8	Asfaltimi i rrugës në Grashticë – Lagjja e Epërme, faza I. Shtresimi i trupit të rrugës me asfalt është përfunduar, pritet ndërtimi i murit mbrojtës me pahi elastike.
9	Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve në rrugën lidhëse në Hajvali. Të gjitha punimet në tërësi janë kryer, është bërë pranimi teknik dhe pagesa përfundimtare nuk është bërë për shkak të procedurave të thesarit.
10	Asfaltimi i rrugëve ”Eqrem Çabej”, ”Armend Daci” dhe “Veterniku”. Të gjitha punimet në tërësi janë kryer dhe është bërë pranimi teknik.
11	Asfaltimi i rrugës për ndërtimin e kolektorit dhe kanalizimit fekal prej rrugës “Abedin Rexha” deri te lidhja me rrugën “Ibrahim Fehmiu”. Shtresimi i rrugës me bituzhavorr është bërë, mirëpo për shkak të kushteve klimatike, asfaltbetoni nuk është bërë.
12	Hartimi i projekteve të mbikalimeve metalike në tri lokacione të ndryshme në Prishtinë. Hartimi i projekteve është përfunduar.
13	Rindërtimi i disa rrugëve dhe kanalizimeve në lagjet “Dodona”, “Vreshtat” dhe “Kodra e Trimave” - Punimet janë duke u zhvilluar, ku deri me tani janë kryer 50% te punimeve.
14	Asfaltimi i rrugës në Barilevë - të gjitha punimet në tërësi janë kryer dhe është bërë pranimi teknik, mirëpo pagesa nuk është realizuar, gjegjësisht thesari është mbyllur me 20 dhjetor dhe pagesa ka mbetur për janar të vitit 2013.
15	Rregullimi i rrugëve dhe parkingjeve (“Qamil Hoxha” dhe “Sylejman Vokshi”), ndërtimi i murit mbrojtës në rrugën “Nexhmedin Llumnica” dhe rregullimi i kanalizimit dhe rrugës ekzistuese te Varrezat e Qytetit. Të gjitha punimet në tërësi janë kryer dhe është bërë pranimi teknik.
16	Rindërtimi i rrugëve në Mat, grupi I. Të gjitha punimet janë kryer dhe është bërë pranimi teknik, mirëpo për shkak të problemeve pronësore-juridike, kanalizimi i përroit ka mbetur pa u realizuar.
17	Sanimi i gropave në qytet. Të gjitha punimet në tërësi janë kryer dhe është bërë pranimi teknik.
18	Asfaltimi i segmentit të rrugës Slivovë – Dragovc. Të gjitha punimet në tërësi janë kryer dhe është bërë pranimi teknik.
19	Rindërtimi i rrugëve në lagjen “Mati”, grupi II. Punimet nuk kanë përfunduar, ka ngecje, sepse nuk iu është përmbajtur planit dinamik të paraparë nga punëkryesi “Bejta Commerce”. Punimet do të vazhdojnë me krijimin e kushteve, gjegjësisht me përmirësimin e motit.
20	Furnizimi dhe montimi i pllakave në sheshin “Ibrahim Rugova”. Punimet janë në realizim e sipër.
21	Ndërtimi i rrugës “Malush Kosova”, faza III. Punimet nuk kanë filluar ende, mirëpo me përmirësimin e kushteve klimatike punimet do të

	rifillojnë
22	Rindërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Behar Begolli”. Shtresimi i trupit të rrugës me bituzhavorr dhe me kubëza në pjesën e trotuarit, rrjeti i kanalizimit fekal , atij atmosferik dhe i ujit ka përfunduar, mirëpo me përmirësimin e motit pritet shtresimi i trupi të rrugës me asfaltbeton.
23	Ndërtimi i disa rrugëve në Hajvali, Kalabri dhe te ish-Fabrika e Amortizatorëve. Punimet janë duke u zhvilluar, mirëpo për shkak të motit të lig punimet janë ndërprerë deri sa të krijohen kushtet për punë.
24	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në Prugovc. Punimet janë duke u zhvilluar, mirëpo për shkak të motit të lig punimet janë ndërprerë derisa të krijohen kushtet për punë.
25	Ndërtimi i disa rrugëve: “Syllë Hotlla”, “Evlia Çelebiu” dhe “Josif Bageri” Punimet janë duke u zhvilluar, mirëpo për shkak të motit të lig punimet janë ndërprerë derisa të krijohen kushtet për punë.
26	Ndërtimi i dy mbikalimeve te shkolla e mesme e mjekësisë “Dr.Ali Sokoli” dhe te shkallët në lagjen “Arbëria”. Mbikalimi te shkolla e mjekësisë është në përfundim e sipër, ndërsa në “Arbëri” ende nuk kanë filluar punimet për shkak të pronësisë së Hekurudhës.
27	Asfaltimi i rrugës në Busi dhe Marec. Punimet janë në realizim, ka probleme pronësore-juridike, që është në procedim të zgjidhjes.
28	Ndërtimi i rrugëve me zhavorr në Koliq, Mramor dhe Bërnice e Ulët. Punimet janë duke u zhvilluar, mirëpo për shkak të motit të lig punimet janë ndërprerë derisa të krijohen kushtet për punë.
29	Ndërtimi i disa rrugëve me kubëza në lagjet: “Kodra e Trimav”, “Veterniku” dhe “Kalabria”. Punimet janë duke u zhvilluar, mirëpo për shkak të motit të lig punimet janë ndërprerë derisa të krijohen kushtet për punë.
30	Asfaltimi i segmentit të unazës qendrore - pjesa perëndimore. Muret mbrojtëse janë realizuar, punimet janë ndërprerë për shkak të problemeve pronësore me Hekurudhat e Kosovës, ku pritet arritje e marrëveshjes.
31	Rindërtimi i disa krahëve të rrugës “Shaban Shala” dhe rrugës “Asdreni”. Punimet ende nuk kanë filluar, mirëpo me përmirësimin e motit do të bëhet rifillimi i punimeve.
32	Ndërtimi i rrugëve me zhavorr në fshatrat Marevc, Keqekollë dhe Prapashticë. Të gjitha punimet janë kryer dhe është bërë pranimi teknik
33	Asfaltimi i segmentit të rrugës Dabishec – Hajkobilë. Shtresimi i rrugës me bituzhavorr është bërë, mirëpo punimet janë në realizim e sipër.
34	Rindërtimi i rrugëve lidhëse Mat – rr. "Isa Kastrati” dhe Hajvali. Punimet janë duke u zhvilluar, mirëpo për shkak të motit të lig punimet janë ndërprerë derisa të krijohen kushtet për punë.
35	Ndërtimi i rrethrotullimit në dalje të Prishtinës - drejtimi i Veternikut, pjesa e dytë. Nënkalimet - punimet janë duke u zhvilluar, mirëpo për shkak të motit të lig punimet janë ndërprerë derisa të krijohen kushtet për punë. Është financim i përbashkët me Ministrinë e Infrastrukturës. Ka probleme pronësore, por jemi në prag të zgjidhjes së kontesteve.
36	Ndërtimi i rrethrotullimit në dalje të Prishtinës - drejtimi i Veternikut, pjesa e tretë. Punimet janë duke u zhvilluar, mirëpo për shkak të motit të lig punimet janë ndërprerë derisa të krijohen kushtet për punë. Është financim i përbashkët me Ministrinë e Infrastrukturës. Ka probleme pronësore, por jemi në prag të zgjidhjes së kontesteve.
37	Ndërtimi i rrethrotullimit në dalje të Prishtinës - drejtimi i Veternikut, pjesa e parë. Punimet janë duke u zhvilluar, mirëpo për shkak të motit të lig punimet janë ndërprerë derisa të krijohen kushte për punë. Është financim i përbashkët me Ministrinë e Infrastrukturës. Ka probleme pronësore, por jemi në prag të zgjidhjes së kontesteve.

Disa prej këtyre projekteve barten në vitin 2013, për shkak të dinamikës së punës dhe natyrës së kontratës, sepse një numër i kontratave është lidhur në pjesën e dytë të vitit, për shkak të procedurave të gjata të prokurimit. Gjithashtu, vonesat janë shkaktuar edhe

nga problemet pronësore të paraqitura në terren. Si rezultat, nuk ka pasur mundësi të kryhen shumë punë sipas kontratave. Në vijim është dhënë lista e rrugëve që barten në vitin 2013:

1. Ndërtimi i vazhdimit të rrugës “Enver Maloku” është në procedurë deri te rruga “Ndue Perllëshi” për eksproprijim.
2. Ndërtimi i rrugës paralele Prishtinë – Shkup. Punimet janë ndërprerë, por pritet të behet eksproprijimi dhe të vazhdojnë punimet.
3. Rindërtimi i rr. “Ndue Perllëshi” nga rr. “M. Fejza” deri te Qendra e Mjekësisë Familjare Mati 1. Punimet janë ndërpre, por pritet të bëhet eksproprijimi dhe të vazhdojnë punimet.
4. Ndërtimi i rrugës "B", faza e katërt. Është kontraktuar, mirëpo për shkak të eksproprijimit ende nuk kanë filluar punimet për realizimin e kontratës.
5. Ndërtimi i “Sheshit të Pavarësisë - Ibrahim Rugova”.
6. Ndërtimi i rrugës mbi kolektorin atmosferik të lumit Prishtina në lagjen “Kalabria”.
7. Asfaltimi i rrugës në Grashticë – Lagja e Epërme - faza I.
8. Rindërtimi i disa rrugëve dhe kanalizimeve në lagjet: “Dodona”, “Vreshtat” dhe “Kodra e Trimav”.
9. Ndërtimi i sheshit “Zahir Pajaziti”.
10. Ndërtimi i rrugës “Malush Kosova”, faza III.
11. Rindërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Behar Begolli”.
12. Ndërtimi i disa rrugëve në Hajvali, lagjen “Kalabria” dhe te ish-Fabrika e Amortizatorëve.
13. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në Prugovc.
14. Ndërtimi i disa rrugëve: “Syllë Hotlla”, “Evlia Çelebi” dhe “Josif Bageri”.
15. Ndërtimi i dy mbikalimeve te shkolla e mesme e mjekësisë “Dr. Ali Sokoli” dhe te shkallët e lagjes “Arbëria”.
16. Asfaltimi i rrugës në Busi – Marevc.
17. Ndërtimi i disa rrugëve me kubëza: Kodra e Trimave, Veterniku dhe Kalabria.
18. Asfaltimi i segmentit të unazës qendrore - pjesa perëndimore.
19. Rindërtimi i disa krahëve të rrugës “Shaban Shala” dhe rrugës “Asdreni”.
20. Asfaltimi i segmentit të rrugës Dabishec – Hajkobillë.
21. Rindërtimi i rrugëve lidhëse Mat, rr. "Isa Kastrati" dhe Hajvali.
22. Ndërtimi i rrethrotullimit në dalje të Prishtinës – drejtimi i Veternikut, pjesa II.
23. Ndërtimi i nënkalimeve.
24. Rrethrotullimi në dalje të Prishtinës – drejtimi i Veternikut, pjesa III.
25. Ndërtimi i rrethrotullimit në dalje të Prishtinës – drejtimi i Veternikut, pjesa I.

#### **d. Hartimi i projekteve dhe detyrave projektuese**

Duke marrë për bazë Ligjin mbi planifikimin hapësinor, Ligjin mbi ndërtimin e objekteve investive, si dhe Ligjin për projektim, e në veçanti planet rregulluese, janë hartuar detyrat projektuese për tri mbikalime në tri lokacione të ndryshme në Prishtinë. Janë kryer detyra projektuese edhe për rrugën Busi - Marevc. Gjatë hartimit të projekteve nga kompanitë fituese të tenderit, është kërkuar që këto kompani të kenë kontakte të

vazhdueshme me drejtorinë komunal dhe kompanitë publike për përvetësimin e varianteve më të volitshme për projektimin e instalimeve nëntokësore.

Duke u bazuar në kërkesat e shumta të qytetarëve për rregullimin urgjent të infrastrukturës rrugore në lagjet e tyre dhe domosdoshmërinë e intervenimit, ekipi teknik hartoi këto projekte:

1. Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik nga rruga " Bill Klinton" përreth Doganës, deri te Ambasada amerikane në lagjen "Arbëria", si dhe rindërtimi i rrugës në drejtim të rrethrotullimit në lagjen "Lakërishta".
2. Rindërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve në rrugën lidhëse "Hasan Remniku" - "Haxhi Zeka" dhe rrugët "Dervish Cara" dhe "Enver Berisha".
3. Rindërtimi i rrugëve lidhëse në Hajvali dhe Mramor.
4. Asfaltimi i rrugëve në Shkabaj dhe Rimanishtë.
5. Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve në rrugën lidhëse në Hajvali.
6. Asfaltimi i rrugëve: "Eqrem Çabej", "Armend Daci" dhe "Veterniku".
7. Asfaltimi i rrugës për ndërtimin e kolektorit dhe kanalizimit fekal prej rrugës "Abedin Rexha" deri te lidhja me rrugën "Ibrahim Fehmiu".
8. Rindërtimi i disa rrugëve dhe kanalizimeve në lagjet: "Dodona", "Vreshtat" dhe "Kodra e Trimav".
9. Rregullimi i rrugëve dhe parkingjeve ("Qamil Hoxha" dhe "Sylejman Vokshi"), ndërtimi i murit mbrojtës në rrugën "Nexhmedin Llumnica" dhe rregullimi i kanalizimit dhe rrugës ekzistuese te Varrezat e Qytetit.
10. Rindërtimi i rrugëve në Mat – grupi I.
11. Rindërtimi i rrugëve në lagjen Mat – grupi II.
12. Ndërtimi i disa rrugëve në Hajvali, "Kalabria" dhe te ish-Fabrika e Amortizatorëve.
13. Ndërtimi i disa rrugëve: "Syllë Hotlla", "Evlija Celebi" dhe "Josif Bageri".
14. Ndërtimi i disa rrugëve me kubëza në lagjet: "Kodra e Trimav", "Veterniku" dhe "Kalabria".
15. Rindërtimi i disa krahëve të rrugës "Shaban Shala" dhe rrugës "Asdreni".

## **7. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT**

Gjatë vitit 2012, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS) ka realizuar objektivat në bazë të politikave programore dhe prioriteteve. Janë shënuar festat dhe ngjarjet e mëdha kulturore komunale dhe shtetërore. Janë pranuar, shqyrtuar dhe proceduar kërkesat për subvencionim të projekteve nga kultura, rinia dhe sporti. Janë investuar 2.6 milionë euro në projekte kulturore, rinore dhe sportive dhe janë shpenzuar 337,169 euro, si përkrahje për 358 aktivitete kulturore, rinore dhe sportive.

### **a. Investimet kapitale**

Investimet totale në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit kapin vlerën prej 2.6 milion euro.

Në fushën e kulturës janë realizuar këto projekte:

- Biblioteka e qytetit të Prishtinës "Hivzi Sylejmani" – faza përfundimtare;

- Restaurimi i Xhamisë së Çarshisë – faza përfundimtare;
- Restaurimi dhe funksionalizimi i Hamamit të Madh – faza përfundimtare;
- Furnizimi me libra;
- Inventarizimi i bibliotekës së qytetit të Prishtinës “Hivzi Sylejmani” – në proces të tenderimit;
- Hapësira për Qendrën Kulturore të Fëmijëve, Sektori i filmave të animuar (investim i DSHPMSh-së / shfrytëzuar nga DKRS-ja).

Në fushën e rinisë dhe sporteve janë realizuar këto projekte:

- 15 terrene sportive, nga të cilat 9 kanë përfunduar, kurse të tjera janë në procesin e ndërtimit;
- Panoramës së bjeshkatarisë në Gërmi – në proces të tenderimit;
- Shtegu i atletikës – në vazhdim;
- Renovimi i pishinës së Gërmisë, guaca, mbulimi i amfiteatrit, fushat e tenisit dhe shëtitorët, hapësira për rrezitje, gardëroba etj., - kontraktuar, pritët të fillojnë punimet;
- Këndet e lodrave (tri lagje në Prishtinë) – në vazhdim;
- Renovimi i strehimoreve për shfrytëzim nga Qendrat Rinore (Investim i DSHPMSh-së / shfrytëzuar nga DKRS-ja).

#### **b. Shënimi i ngjarjeve të rëndësishme**

Në programin për shënimin e festave dhe ngjarjeve të mëdha kulturore komunale dhe shtetërore, kombëtare dhe ndërkombëtare, Drejtoria ka investuar 82,795 euro në shënimin e këtyre ngjarjeve: Dita e Dëshmorëve të Prishtinës, Dita e Evropës 2010, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, Dita e Prishtinës “11 Qershori”, Dita e Pavarësisë së SHBA-së, Mbrëmjet verore „Vera në Prishtinë“, Festivali i dytë i Teatrove të Kukullave, Festivali ndërkombëtar i fëmijëve “Ylberi i Prishtinës”, Muaji i Rinisë, Dita e Flamurit “28 Nëntori” – 100-vjetori, ndriçimi dhe zbukurimi i qytetit për festat e fundvitit, festa e Vitit të Ri, Sportisti i Vitit 2012, turneu memorial i shahut “Hyzri Talla” etj.

#### **c. Mbështetja e organizatave kulturore, rinore dhe sportive**

Drejtoria ka bashkëpunuar me organizata të ndryshëm, ku janë mbështetur 358 aktivitete dhe projekte, me një shumë totale prej 337,169 euro. Duhet cekur se numri i projekteve të mbështetura në kulturë, rini dhe sport, si dhe shuma e mjeteve është rritur nga viti në vit.

Në fushën e kulturës janë mbështetur 232 aktivitete, me 241,269 euro:

- |   |          |
|---|----------|
| • Botime (87 aktivitete)  | 44,150 € |
| • Manifestime (31 aktivitete)                                       | 50,694 € |
| • Festivale (16 aktivitete)   | 36,834 € |
| • Mbështetje të OJQ-ve (28 aktivitete)                              | 32,725 € |
| • Mbështetje e artistëve për udhëtime jashtë vendit (23 aktivitete) | 21,523 € |
| • Ekspozita dhe koncertet (19 aktivitete)                           | 19,023 € |
| • Promovime, shfaqje, hulumtime, trajnime dhe filma (24 aktivitete) | 36,320 € |

Në fushën e sporteve janë mbështetur 90 aktivitete, në vlerë prej 68,900 euro:

• Klubet e karatesë (17 aktivitete)	8,100 €
• Klubet e hendbollit (5 aktivitete)	9,500 €
• Klubet e volejbollit (3 aktivitete)	2,400 €
• Klubet e basketbollit (3 aktivitete)	7,000 €
• Klubi i taekwando's (5 aktivitete)	3,100 €
• Klubet e notit (3 aktivitete)	2,000 €
• Klubi i futbollit (7 aktivitete)	8,500 €
• Klubet çikliste (2 aktivitete)	1,700 €
• Aeroklubet (3 aktivitete)	2,300 €
• Klubi i skitarëve (1 aktivitete)	1,000 €
• Maratona/atletikë (3 aktivitete)	2,500 €
• Klubet e shenjëtarisë (4 aktivitete)	2,800 €
• Klubet e pingpongut (5 aktivitete)	2,000 €
• Klubi i boksit (3 aktivitete)	1,300 €
• Klubi i shahut (4 aktivitete)	2,200 €
• Klubet e tjera sportive (11 aktivitete)	7,100 €
• Sportist/trajner (11 aktivitete)	5,400 €

Në fushën e rinisë janë mbështetur 36 aktivitete të ndryshme, në vlerë prej 27,000 euro.

#### **d. Institucionet kulturore ndërkomunale**

**Teatri i qytetit të Prishtinës “Dodona”** ka realizuar disa premiera, shfaqje dhe programe të huazuara ose në marrëveshje me ekzekutues të ndryshëm. Teatri ka arritur të realizojë 179 programe të ndryshme, prej të cilave disa premiera, si: “Trojanët”, “Killing Softly”, “Improvizim - lojë – ritual”, “Ëndrra e një nate vere”, “Këngëtarja tullace” etj. Teatri i kukullave ka realizuar: “Peshkatari dhe peshku”, “Libri shumëngjyrësh”, “Faqet ngjyra-ngjyra” etj. Në “Skena e mbrëmjes” janë realizuar 38 programe dhe shfaqjet janë shikuar nga 3,208 shikues. Teatri i kukullave ka realizuar 116 repriza me 14,429 shikues. Janë realizuar edhe 22 programe të tjera mysafire, ku ka pasur 2,708 shikues. Statistikat tregojnë se ky teatër po e mbanë ritmin e duhur, duke zhvilluar aktivitetin e vetë të rregullt.

**Arkivi Komunal i Prishtinës** ka realizuar planin sipas dinamikës së planifikuar për vitin 2012. Është rregulluar lënda arkivore në mënyrën profesionale, siç parashihet me Rregulloren e arkivit dhe është përgatitur regjistri (udhërrëfyesi). Është arritur marrëveshja me Drejtorinë e Kadastrit të Komunë së Prishtinës për rregullimin e lëndës arkivore në ambientet e ndërtesës së re të Komunës. Është blerë aparati fotokopjues shumë funksional si donacion nga USAID-i dhe Komuna e Prishtinës. Është punuar në rregullimin dhe përpunimin e lëndës arkivore të urbanizmit. Gjatë vitit 2012, një numër jashtëzakonisht i madh i palëve kanë kërkuar dokumentacion të ndryshëm, duke filluar nga dosjet e punëtorëve, deri te ato pronëso-ro-juridike të institucioneve të ndryshme.

**Biblioteka e qytetit “Hivzi Sylejmani”**, ka pasuruar fondin e librave me 807 tituj dhe 6,537 ekzemplarë, të siguruar nga këto burime: me 432 tituj dhe 3415 ekzemplarë nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nga Panairi i Librit në Prishtinë me 22 tituj dhe 100 ekzemplarë, nga Panairi Librit në Tiranë me 90 tituj dhe 332 ekzemplarë, nga botuesi “Koha ditore” dhuratë 68 tituj dhe 639 ekzemplarë, nga “Logos A” dhuratë 139 tituj dhe 1996 ekzemplarë, dhurata të ndryshme me 56 tituj dhe 436 ekzemplarë. Është promovuar libri monografik “Biblioteka Publike Hivzi Sylejmani e Prishtinës (1945-2010)” e autorit Sylejman Pireva. Janë mbajtur trajnime të ndryshme për stafin e bibliotekës. Është fituar një donacion nga Ambasada amerikane në Kosovë, në vlerë prej \$29,913 për realizimin e projektit “Library Collections @ Your Screen”. Është hapur biblioteka në shkollën fillore “Xhavit Ahmeti”, me një fond shumë të pasur të librave. Janë ofruar libra për shkollën fillore “Shkolla e Gjelbër” (540 tituj dhe 397 ekzemplarë), për gjimnazin “Xhevdet Doda” (488 tituj dhe 1110 ekzemplarë), si dhe janë dhuruar për bibliotekën në Medvegjë (84 tituj dhe 124 ekzemplarë).

**Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës** ka zhvilluar aktivitetet e rregullta në këto seksione: kor, instrumentist, vallëzim folklorik, dramë, klubin e ambasadorëve, klubin e letrarëve dhe aktivitete sportive. Gjatë gjithë vitit janë realizuar ngjarje kulturore për fëmijë dhe të tjerë në kuadër të shënimit të datave të ndryshme. Është realizuar koncerti me rastin e festës së Pavarësisë. E përkrahur nga UNICEF-i, është realizuar fushata kundër pirjes së duhanit, është shënuar Dita e 7 Marsit, vizita e Ambasadorëve të Rinj në Forcën e Sigurisë së Kosovës etj. Ansambli i Valleve ka marrë pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Fëmijëve në Sakaria të Turqisë. Është organizuar manifestimi me rastin e Ditës së Evropës, më 9 maj, Dita e Prishtinës, më 11 qershor, koncerti për diasporën, vizita të ndryshme dhe pjesëmarrje në festivale në vend dhe jashtë.

## **8. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJES DHE SHPËTIMIT**

### **a. Sektori i shërbimeve publike**

Gjatë vitit 2012, është hartuar Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave, Plani për menaxhimin e mbeturinave, Plani për fillimin e riciklimit të mbeturinave në lagjen “Dardania”, organizimi i fushatës së vetëdijesimit për ndarjen e mbeturinave, detyra projektuese për Strategjinë e transportit etj. Shërbimet përkatëse kanë mbikëqyrë funksionimin e shërbimeve të transportit publik dhe projektet e sinjalizimit, të vendosjes së shenjave informuese dhe shenjzimitin e emrave të rrugëve, lagjeve dhe vendbanimeve etj. Është punuar edhe në projektin për riorganizimin e transportit publik të udhëtarëve me autobus.

Për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve dhe trotuareve janë kontraktuar kompani: në lloton e parë të mirëmbajtjes verore janë përfshirë 118 rrugë dhe trotuare, në lloton e dytë 82 rrugë dhe trotuare, dhe në të tretën 95 rrugë dhe trotuare. Po ashtu, janë mirëmbajtur (larë dhe fshirë) edhe hapësirat tjera, si: sheshet, tarracat, nënkalimet, shtigjet, parkingjet dhe hapësirat tjera rreth ndërtesave të institucioneve dhe objekteve



tjera. Janë mirëmbajtur 37 rrugë rurale të rendit të katërt të paasfaltuara nga kompania “Dardania”. Në vitin 2012, në listën e mirëmbajtjes verore janë përfshirë 35 rrugë më shumë se në vitin paraprak.

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve, trotuareve dhe hapësirave tjera urbane, ka qenë e planifikuar në tri loto (loto e parë 96 rrugë dhe 19 hapësira të parkingjeve, loto e dytë në 75 rrugë, trotuare dhe 8 hapësira të parkingjeve dhe loto e tretë, 89 rrugë dhe trotuare). Ndërsa, në mirëmbajtjen dimërore të rrugëve rurale përfshihen të gjitha fshatrat përgjatë magjistrales Prishtinë - Podujevë dhe magjistrales Prishtinë - Prapashticë. Si gjatë verës, ashtu edhe gjatë dimrit, janë mirëmbajtur 296 rrugë dhe hapësira tjera, prej të cilave 156 janë larë rregullisht gjatë sezonit veror dhe gjatë sezonit dimëror, varësisht nga moti.

Bashkë me NPK ”Hortikultura”, janë mirëmbajtur hapësirat gjelbëruese ekzistuese, si dhe janë bërë punime në zgjerimin e hapësirave të reje gjelbëruese, të cilat janë mbjellë me fidanë. Janë mbjellë rreth 150,000 fije lulesh sezonale në parqe dhe përgjatë disa rrugëve të qytetit. Kjo kompani ka pastruar mbeturinat e të gjitha llojeve nëpër parqe dhe hapësira gjelbëruese.

Projektet që janë realizuar gjatë vitit 2012:

1. Është përfunduar objekti i zjarrfikësve;
2. Mirëmbajtja e semaforëve;
3. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve, trotuareve, zhbllokimi i kanalizimit atmosferik dhe pusetave;
4. Mirëmbajtja e rrugëve, trotuareve dhe kanalizimit atmosferik;
5. Mirëmbajtja verore e rrugëve rurale;
6. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale;
7. Mirëmbajtja e shatërvanëve dhe krojeve;
8. Mirëmbajtja e ndriçimit publik;
9. Mirëmbajtja e sistemit të radiolidhjeve;
10. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal;
11. Punimi, furnizimi dhe vendosja e shenjave të komunikacionit;
12. Ndërtimi dhe modernizimi i semaforëve;
13. Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik;
14. Riparimi i ashensorëve;
15. Bartja e mbeturinave të ngurta të hedhura pa kritere;
16. Pastrimi i shtratit të lumenjve, kolektorit atmosferik, furnizimi me kapakë;
17. Rregullimi i shtigjeve në parqet e qytetit;
18. Mirëmbajtja e sipërfaqeve publike gjelbëruese;
19. Rregullimi i vendeve të kontejnerëve;
20. Blerja e kontejnerëve;
21. Trajtimi i qenve endacakë;
22. Blerja e kamionit me shportë,
23. Blerja e makinave për kositjen e barit dhe largimin e borës;
24. Rregull i vendndaljeve të autobusëve;
25. Ndërtimi i tregut të kombinuar-faza e parë;

26. Ndërtimi i shtëpizës te Stacioni i Autobusëve;
27. Furnizimi me material elektrik dhe ngrohje në objektin e zjarrfikësve;
28. Subvencionimi i NPK „Pastrimi”;
29. Subvencionimi i NPK „Trafiku Urban”.

Sfidë kryesore edhe më tutje mbetet mungesa e parkingjeve publike, ngarkesa e madhe në komunikacionin dhe shërbimi i transportit publik të udhëtarëve. Në këtë drejtim, sektori përkatës, në bashkëpunim me policinë, kanë arritur të eliminojnë shumë parregullsi. Shërbimi për shfrytëzimin e hapësirave publike, sipas nevojave të qytetarëve dhe përfaqësuesve të bizneseve të ndryshme, ka shqyrtuar dhe miratuar kërkesat e ndryshme të shtruara nga të lartpërmendurit në përputhje me rregulloren përkatëse.

### **b. Sektori i mbrojtjes dhe shpëtimit**

Shërbimet përkatëse në këtë sektor kanë operuar sipas Planit për mbrojtje nga zjarri për territorin e komunës së Prishtinës, Ligjit për mbrojtje nga zjarri, Planit për reagim emergjent për territorin e Komunës, Planit për reagim emergjent për ndërtesën e re të Komunës, Planin vjetor të punës së KKSB-së. Bazuar në ndryshimin e akteve normative në fuqi, Kuvendi e ka miratuar përbërjen e re të KKSB-së. Ky organ ka mbajtur tetë mbledhje gjatë vitit, ku ka përcjellë dhe ka shqyrtuar vazhdimisht gjendjen e sigurisë në territorin e komunës së Prishtinës, ka hartuar dhe miratuar Planin operativ për mbrojtje nga zjarri gjatë fushatës së korrje-shirjeve dhe shumë aktivitete tjera. Janë mbajtur trajnime me nxënësit e shkollave fillore dhe të punësuarit në ato institucione, për evakuim në raste të fatkeqësive natyrore.

Shërbimi i planifikimit ka grumbulluar të dhënat për resurset humane nga ndërmarrjet publike dhe ato private për reagim në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera në territorin e komunës. Gjatë kësaj periudhe, nga inspektorët e parandalimit dhe hulumtimit, janë hartuar 90 raporte për paraqitje të zjarrit, 74 procesverbale, janë dhënë 723 masa për eliminimin e dobësive subjekteve që veprojnë në territorin e komunës, janë lëshuar 71 pëlqime - elaborate për mbrojtje nga zjarri, janë dhënë 21 vërtetime palëve për nevojat e tyre personale dhe 18 konstatime për gjendjen e objekteve.

Po ashtu, inspektorët e mbrojtjes dhe shpëtimit kanë inspektuar 12 shkolla fillore, 3 shkolla të mesme, 6 institucione parashkollore dhe 28 raste emergjente, në bazë të kërkesave të qytetarëve. Ky shërbim ka lëshuar edhe 32 procesverbale, me të cilat ka urdhëruar subjektet e ndryshme që të hartojnë planet për mbrojtje dhe shpëtim me rastin e fatkeqësive, në përputhje me afatin ligjor. Janë urdhëruar 126 masa tjera të afatizuara për të gjitha subjektet e vizituara.

Janë realizuar dhe janë në procedurë realizimi këto projekte:

1. Renovimi i strehimoreve në lagjet “Kodra e Diellit” dhe “Ulpiana”,
2. Rregullimi dhe thurja e oborrit të BZP-së (Baza e zjarrfikësve),
3. Montimi i 15 hidrantëve në pjesë të ndryshme të qytetit,
4. Furnizimi me pajisje rezervë për BZP-në,
5. Furnizimi me uniforma dimërore dhe verore për zjarrfikësit,

6. Furnizimi i BZP-së me kompresor dhe maska mbrojtëse,
7. Furnizimi me një kompresor të presionit të lartë për mbushjen me ajër të bombolave të aparateve të frymëmarrjes,
8. Furnizimi me maska për frymëmarrje, sipas standardit EN 137 – 50 copë,
9. Furnizimi me 20 komplete aparatesh të frymëmarrjes,
10. Furnizimi me 60 aparate për fikjen e zjarreve fillestare, të tipit S9, dhe 40 aparate të tipit S6,
11. Furnizimi me 10 copë shpinore për fikjen e zjarreve fushore.

**Qendra për Informim, Alarmim dhe Koordinim** ka organizuar kujdestari 24 orë dhe është kujdesur për mirëmbajtjen e monitorëve në Komunë, mirëmbajtjen e radiolidhjeve që i shfrytëzojnë bashkësitë lokale, ka bërë formatizimin e programit të sistemit të qasjes (hyrje-daljeve) në Parkut Rajonal të Gërmisë, ka bërë verifikimin e të gjitha mjeteve teknike dhe radiolidhjeve tjera. Gjatë kësaj periudhe, janë punuar 243 kartela për shërbyesit civilë dhe janë pranuar 2775 informata nga qytetarët dhe subjektet e ndryshme.

**Brigada e zjarrfikësve** gjatë kësaj periudhe ka realizuar detyrat dhe obligimet që janë paraqitur nga fatkeqësitë elementare apo zjarret. Për të ngritur shkallën e cilësisë profesionale të zjarrfikësve, disa zjarrfikës janë trajnuar në programet: "Përdorimi i rrobave mbrojtëse nga materiet e rrezikshme", "Aksidentet në komunikacionin rrugor", "Sistemi i integruar i menaxhimit emergjent" dhe "Taktikat për shuarjen e zjarrit". Tabela në vijim paraqet statistikën e intervenimeve të zjarrfikësve gjatë vitit 2012. Krahasuar me vitin 2011, kur ka pasur 1,739 dalje të ekipeve në terren, prej të cilave zjarre kanë qenë 1500, gjatë vitit 2012 ka pasur 1,993 dalje të ekipeve (apo 15% më shumë). Prej tyre ka pasur 1,565 zjarre për shkak të motit të nxehtë dhe shkaktimit të zjarreve me dhe pa qëllim.

Tabela 9: Statistikat për intervenimet nga zjarrfikësit gjatë vitit 2012

Viti 2012	Dalje	Nr. i zjarreve	Int. teknike	Nr. i zj. pjesëmarrës	Nr. i automjeteve	Orë pune	Të lënduar		Të vdekur	
							Qy	Zj.	Qy	Zj.
Janar	83	61	22	468	146	549:23	2	-	1	-
Shkurt	94	52	42	445	147	472:55	4	-	-	-
Mars	179	156	23	680	240	1006:43	2	1	1	-
Prill	66	48	18	279	96	294:49	11	-	-	-
Maj	95	69	26	416	132	414:00	4	1	-	-
Qershor	88	64	24	366	129	308:26	-	-	1	-
Korrik	244	194	50	791	299	1175:55	-	-	-	-
Gusht	507	443	64	1517	594	2195:06	15	-	1	-
Shtator	273	217	56	831	342	1185:31	5	3	-	-
Tetor	209	166	43	680	253	829:59	4	-	1	-
Nëntor	85	45	40	310	109	252:45	4	-	-	-
Dhjetor	70	50	20	293	102	265:54	8	-	2	-
Gjithsej	1993	1565	428	7076	2589	8951:29	59	5	7	-

Brigada e Zjarrfikësve në Prishtinë, përpos në territorin e Prishtinës, ka mbuluar dhe iu është përgjigjur kërkesave për intervenime edhe në komunat: Fushë - Kosovë, Obiliq,

Lipjan dhe Podujevë. Më poshtë është paraqitur pasqyra e intervenimit në territorin e këtyre komunave.

Tabela 10: Statistikat për intervenimet nga zjarrfikësit gjatë vitit 2012, sipas komunave.

	Komunat	Dalje	Zjarre	Intervenimet teknike dhe shërbime
1	Prishtinë	1,689	1,329	360
2	Fushë - Kosovë	199	138	61
3	Obiliq	94	88	6
4	Podujevë	10	9	1
5	Lipjan	1	1	-
	Gjithsej	1,993	1,565	428

### c. Bashkëpunimi dhe donacionet

Drejtorja ka bashkëpunuar me disa donatorë në realizimin e disa projekteve në vlerë e përgjithshme prej 1,892,395 €, të dhëna në vijim:

1. USAID – Furnizimi me 250 shporta të mbeturinave dhe montimi i tyre, në trotuare dhe hapësira të tjera, vlera 45.000 \$ (apo 33,750.00 €);
2. MAPL – Participimi i financimit të pjesës së parë të projektit për ndërtimin e tregut të kombinuar, vlera 90.000 €;
3. Komisioni Evropian - IOM – rregullimi i Parkut të lagjen “Arbëria”, në vlerë prej 200,000 €;
4. Banka Botërore - MPMS – mirëmbajtja e varrezave, 74,145 €;
5. Banka Botërore - MPMS – rregullimi (gjelbërimi) i oborrit të gjimnazit “Xhevdet Doda” dhe sh.f. ”Naim Frashëri”, vlera 50.000 €;
6. UNDP – Trajtimi i qenve endacakë 7.500 €;
7. Komisioni Evropian – rregullimi i Parkut të Gërmisë, vlera 350,000.00 €;
8. GIZ – renovimi i zyrave në kompaninë “Pastrimi”, pajisja me inventar, pajisja me teknologji informatike dhe furnizimi me rroba pune për punëtorë, vlera 35.000 €;
9. GIZ - pajisja me teknologji informatike dhe me program profesional për DSHPMSh, vlera 10.000 €;
10. GIZ – financimi i projektit “Fushata e vetëdijesimit për fillimin e ndarjes së mbeturinave, në lagjen “Dardania” në Prishtinë , vlera 22.000 €;
11. GIZ - Furnizimi dhe montimi i 130 shportave të mbeturinave në hapësira të ndryshme të qytetit, vlera 20.000 €;
12. JICA – furnizimi i kompanisë “Pastrimi” me 10 kamionë për bartjen e mbeturinave, furnizimi me pjesë ndërrimi dhe me makina për ndërrimin e gomave të kamionëve, vlera mbi 1.000.000 €.

## 9. DREJTORIA E KADASTRIT

Drejtorja ka qenë e angazhuar në zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetën referuese homogjene, rikonstruktimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informative mbi tokën dhe pronën, përmirësimin e transferimit të tokës, digjitalizimi i pikave poligonale dhe trigonometrike, azhurnimi i pjesës grafike dhe matjeve të reja, shërbimet e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës etj.

Drejtoria kryen edhe shërbimet për shënimet e digjitalizuara, incizimin e sipërfaqes, regjistrimin e pronës së paluajtshme, procedurat administrative për rikthimin e paluajtshmërisë ish-pronarëve, evidencon dhe shlyen masat e përkohshme sipas aktvendimit të gjykatës kompetente, regjistrimin dhe çregjistrimin e hipotekave etj.

Drejtoria e Kadastrit gjatë vitit ka realizuar projekte si në vijim:

1. Krijimi i Kadastrit nëntokësor (përçojat dhe objektet nëntokësore) - kryesisht zona juglindore e qytetit, në të cilën janë incizuar 556 km gjatësi të gjendjes faktike, krijimin e modelit digjital (GIS), matje 3D (xyz) për të gjitha pusetat, objektet nëntokësore nëpër të cilat kalojnë përçoja nëntokësore, mbledhja e informacioneve drejtpërdrejt në terren për pozicionin e saktë të linjave nëntokësore (kablo, gypa në shfrytëzim dhe për shfrytëzim, fibra optik etj.) përcaktimi i diametrit të gypave nëntokësor, si dhe futja e këtyre informacioneve në modelin digjital të krijuar paraprakisht. Si rezultat përfundimtar i këtij projekti është paraparë një model digjital, i cili do të shërbejë si bazë e të dhënave për futjen e informacioneve për përçoja, linjat nëntokësore dhe mbledhjen e informacioneve për një gjatësi të infrastrukturës në kuadër të zonës së caktuar.
2. Kadastru i ndërtesave – regjistrimi i njësive kadastrale: banesa, lokale afariste dhe garazhe), ka vazhduar të krijohet sipas kërkesave të qytetarëve, dhe gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 507 njësi kadastrale (kryesisht në ndërtesat e vjetra).
3. Edhe gjatë kësaj kohe ka vazhduar zbatimi i projektit sipas memorandumit të mirëkuptimit, i nënshkruar në mes të Komunës së Prishtinës dhe Organizatës Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar – GIZ, për projektin “Menaxhimi i tokës/kadastru në Kosovë”. Projekt i filluar nga data 13.04.2011, ku përfshihen:
  - Këshillimi i Drejtorisë gjatë konsolidimit të të dhënave ekzistuese grafike;
  - Zbatimi i masave trajnuese pranë Drejtorisë;
  - Përkrahja e Drejtorisë për optimalizimin e proceseve të punës;
  - Hulumentimi i të dhënave bazë statistikore për kohëzgjatjen e një regjistrimi, përqindjen e pajtueshmërisë së të dhënave kadastrale dhe atyre të librave të regjistrimit me situatën reale, të përqindjes së dhënies së punëve matëse firmave private gjeodezike;
  - Trajnimi i një pjese të gjeodetëve, duke përdorur teknologjinë e sistemit global të navigimit satelitor (GNSS-së);
  - Trajnimi praktik i stafit të nevojshëm mbi kontrollin e stacioneve totale në terren;
  - Krijimi i një baze për kontrollin e instrumenteve gjeodezike (EDM- matja elektronike e distancës në mes dy pikave) në Gërmi;
  - Funkcionalizimi i stacioneve KOPOS (Pozicionimi Satelitor i Kosovës) dhe lëshimi publik i tij në përdorim me 16 nëntor 2012 nga AKK-ja;
  - Janë organizuar edhe disa trajnime të ndryshme dhe vizita studimore në këtë fushë.
4. Rindërtimi i informacioneve kadastrale me financim të Bankës Botërore, të përkrahur e mbikëqyrur edhe nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, në tekstin e mëtejshëm (AKK), është realizuar projekti “Rindërtimi i informacionit kadastral” për zonat: Sofali, Kolovicë dhe Shkabaj. Ndërsa për zonat kadastrale Bardhosh

- dhe Bërnice e Epërme janë realizuar dhe financuar nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, gjegjësisht Agjencia Kadastrale e Kosovës.
5. Gjithashtu edhe në rindërtimin e informacioneve të kadastrave përmes financimit të Bankës Botërore, të përkrahur e mbikëqyrur edhe nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, ka vazhduar për zonat: Lebanë, Trudë, Llukar, Matiçan, Hajvali dhe Çagllavicë, por përfundimi i këtij projektit (sipas dinamikës së punës), duhet të përfundojë gjatë vitit 2013.
  6. Më 15.03.2012 është bërë instalimi i programit të Sistemit informativ kadastral të tokave të Kosovës, në tekstin e mëtejme (SIKTK-shqip) ose (KCLIS - anglisht), nga Programi i regjistrimit të drejtës së pronës së paluajtshme, në tekstin mëtejme (RDPP).

Punët gjeodezike në terren nga sektori privat janë në rritje e sipër dhe gjatë kësaj periudhe janë realizuar 69.70%, ndërsa 31.3% nga Komuna. Koha mesatare e realizimit të lëndëve (bartje) ka qenë 16 ditë (duke llogaritur edhe kohën prej 5 ditë pune për shpalljen publike), ose 10 ditë më shpejt sesa në vitin e kaluar. Në Drejtori kanë arritur një numër i madhe i kërkesave për realizimin e të drejtave pronësore nga persona fizikë, juridikë, gjykatat, AKK-ja dhe AKP-ja.

Gjatë vitit 2012, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka nxjerrë vendime me rastin e rindërtimit të zonave kadastrave, në bazë të të cilit ka evidencuar objektet në certifikatën e pronësisë dhe në kopjen e planit. Kjo ka bërë që objektet e ndërtuara në terren pa leje përkatëse, të barten në dokumentet kadastrale. Kjo vlerësohet se paraqet shkelje të Ligjit për planifikim hapësinor 2003/14, Ligjin e ndërtimit nr. 2004/15, Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural 2009/03- L-989, Ligjin për transportin rrugor, Planin strategjik – zhvillimi urban i Prishtinës 2004-2020, dhe të disa akteve të tjera nënligjore. Drejtorja e Kadastrit, pas marrjes në dijeni të këtyre ndryshmeve, ka bërë kundërshtimin e një gjendjeje të tillë dhe ka kërkuar që menjëherë të rikthehet gjendja e mëparshme. Pas shkresave zyrtare AKK-së, në “certifikatën e pronësisë” është shtuar një rubrikë, në të cilën janë shënuar me "vërejtje" se janë informale-ilegale, ndërsa pjesa grafike (skicat) në hartat kadastrale janë të theksuara me ngjyrë tjetër, që nënkupton se janë objekte pa leje. Po ashtu, janë paraqitur disa probleme në zbatimin e programit nga AKK-ja, të quajtur SIKTK, i cili është instaluar pa paralajmërim dhe pa përgatitje adekuate. Në këtë program janë manifestuar gabime të ndryshme, si: humbja e disa pronave, hipotekave, masave të ndalesave dhe qiradhëniet për 99 vjet etj., të cilat pastaj në proces të verifikimit janë kthyer në sistem.

## **10. DREJTORIA E INSPEKSIONIT**

Aktiviteti i Drejtorisë së Inspektionit gjatë periudhës raportuese është orientuar në inspektimin e zbatimit të ligjit dhe të rregulloreve të miratuara në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, që kanë të bëjnë me lëmin e ndërtimit, veprimtaritë komunale dhe të komunikacionit, mbrojtjen e ambientit, bujqësinë, veterinarinë dhe sanitarinë. Janë kryer edhe punë të tjera në bazë të urdhërësive të organeve kompetente komunale, në bazë të kërkesave të qytetarëve, të ndërmarrjeve komunale dhe në bazë të kërkesave të Policisë

së Kosovës. Kanë qenë i angazhuar një staf prej 51 punëtorëve në kryerjen e detyrave të cekura më lart. Gjatë vitit, drejtoria ka procesuar 4,090 lëndë të arritura nga palët. Një numër prej tyre që figurojnë në tabelën e ‘Qendrës për shërbime me qytetarë’ si lëndë të pakryera të kësaj drejtorie, i përkasin inspektionit të punës dhe inspektionit të tregut të cilat më nuk janë kompetencë e komunës, por që kanë arritur më herët në komunë. Këto inspeksione tani funksionojnë në kuadër të ministrive përkatëse.

#### **a. Sektori i ndërtimit**

Në bazë të Ligjit për ndërtim dhe në bazë të Udhëzimeve administrative, është bërë inspektimi i ndërtimeve në territorin e komunës së Prishtinës. Gjatë vitit 2012, janë trajtuar 384 lëndë: objektet kolektive për banim 55, objekte individuale për banim 208, objekte të ndryshme të filluara pa leje 123 (anekse, autolarje, garazhe, depo, gropime, thyerje të mureve, mbindërtime, mbyllje të ashensorëve etj.). Nga objektet e ndërtuara pa leje, 40 janë rrënuar, ndërsa të tjerat janë në procedurë.

#### **b. Sektori komunal dhe i mbrojtjes së ambientit**

Janë zhvilluar aktivitete në largimin e shitësve ambulantë nga rrugët, trotualet dhe hapësirat publike. Në bashkëpunim me kompaninë KUR “Prishtina”, është bërë kontrollimi për keqpërdorimin e ujit të pijes, ndërsa në bashkëpunim me Agjencinë e Pyjeve, është bërë konfiskimi i lëndëve drunore, kontrollimi i kompanive gjatë sezonit dimëror për largimin e borës nga rruga dhe trotualet, kontrolli për furnizim të qytetarëve për ujë të pijes, kontrolli i rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik, kontrolli për bartje të mbeturinave nga kontejnerët dhe deponimi ilegal i mbeturinave etj.

Gjatë vitit 2012, ky sektor ka bërë 16,789 kontrollime: procesverbale 1,725, vendime 349, kërkesa 213, ankesa 55, njoftime 167, aktpërcjellëse 38, fletëparaqitje për gjykatë 100, vendime për kujdestari 54, vendime për ditë te lira 34, rrënime të bëra 309 (mbuloja, plato, shtojca, shtylla metalike, garazhe, tarraca, korniza, reklama, konstruksione, rrethoja, shkallë, bazamente, anekse ndërtime), largim (të reklamave, panove, frigoriferëve, tavolina e karrigeve) 325, konfiskim (të tavolinave-karrigeve, reklamave, stendave lëvizëse, panove reklamuese) 269, largim të shitësve (ambulantë, të druve, të gëlqeres) 640, kontrolle të autolarjeve 72, largim (të automjeteve të rënda, makinave nga sipërfaqja publike) 270, largim të rrethojave metalike nga prona komunale 590 metra, largim të shtyllave metalike antiparking nga trotuari 320 copë, largim të kubzave të betonit dh shtigjeve nga sipërfaqet publike 152 m<sup>3</sup>, largim të materialeve inerte nga sipërfaqet publike 130 m<sup>3</sup>, konfiskim të lëndëve drunore 33,5 m<sup>3</sup>.

#### **c. Sektori i komunikacionit**

Ky sektor ka vepruar duke u bazuar në planin e punës për ndalimin dhe parandalimin e operatorëve ilegalë, që operojnë ilegalisht në transportin e udhëtarëve. Gjatë vitit 2012, ka trajtuar 2,109 lëndë. Nga këto lëndë, janë shkruar 1,991 procesverbale dhe janë përcjellë në GJKK (Gjykatën Komunale për Kundërvajtje) 1,609 lëndë. Prej lëndëve të përcjella në GJKK, janë kryer vetëm 317. Janë konfiskuar 684 automjete,

janë konfiskuar targa e 199 automjeteve, janë kthyer 2 lëndë dhe 1 lëndë është në procedurë. Shuma dënimeve të shqiptuara kap vlerën 63,790 euro.

#### **d. Sektori sanitar - veterinar**

Shërbimi veterinar ka bërë kontrollimin e mishit edhe të produkteve të mishit, të qumështit dhe produkteve me prejardhje shtazore. Njëherësh ka bërë kontrollimin e zbatimit të Ligjit mbi vaksinimin dhe rivaksinimin e kafshëve shtëpiake, qenve dhe maceve në qytet, si dhe dhënia e kartave të identitetit (pasaportave për qenë dhe mace). Gjatë vitit ky sektor ka bërë 2,055 kontrolle të ndryshme, ku janë shkruar 993 procesverbale, janë lëshuar 146 aktvendime, janë dhënë 131 rekomandime sanitare, janë lëshuar fletëparaqitje për kundërvajtje në 72 raste, janë lëshuar 126 urdhëresa, janë lëshuar 201 pëlqime për pranimin e lokaleve, janë marrë 62 mostra të ushqimit, janë bërë 13 inspektime në punkte shëndetësore, 42 inspektime në hoteleri, 51 inspektime në farmaci. Janë therë dhe vulosur me vulë shtetërore në 1,187 raste. Janë asgjësuar artikuj ushqimor në vlerë prej 727,019 euro.

#### **e. Sektori bujqësor**

Gjatë vitit 2012, janë bërë 988 kontrollime, prej të cilave në tregti 530, në hoteleri 458 dhe shërbime të tjera. Prej tyre janë përgatitur 767 procesverbale, janë marrë vendime për asgjësim në 3 raste dhe janë asgjësuar mallra në vlerë prej 3,167 euro.

### **11. DREJTORIA E ADMINISTRATËS**

#### **a. Investimet kapitale**

Gjatë kësaj periudhe është bërë fasadimi i objektit të vjetër të Komunës, montimi i rufepritësit në kulmin e objektit të Komunës, punimi i shkallëve emergjente, finalizimi i renovimit të sallës së Asamblesë komunale dhe hidroizolimi i kulmit të sallës, renovimi i trasesë në objektin e Komunës dhe renovimi i sporteleve dhe shkallëve në objektin e Komunës, renovimi i bodrumit në objektin e vjetër dhe të ri të Komunës, i cili do të përdoret si bufe për punëtorët e Komunës. Është montuar bina, bashkë me pajisjet përkatëse, si ndriçimi, zërimi etj. Janë vendosur dyert nga qelqi në korridore, si dhe janë shtruar me pllaka, janë aktivizuar dy zyra për punë të shërbimeve me qytetarë në dy objektet e Komunës, janë rivendosur kutitë e reja për ankesa dhe tabelat e shpalljeve etj. Janë vendosur dy laura në oborrin e Komunës dhe është rregulluar oborri i Komunës, trotuari përreth dhe parkingu për vetura të punëtorëve të Komunës në objektin e vjetër të Komunës.

#### **b. Sektori për punë të Kuvendit dhe ekzekutivit**

Ky sektor ka kryer punë profesionale dhe administrative në përgatitjen e materialeve për mbledhje; bashkëpunim me drejtoritë në hartimin e rregulloreve dhe vendimeve të ndryshme; konsultime dhe ndihmë në miratimin e rregulloreve dhe vendimeve të



ndryshme; përgatitje të rregulloreve, vendimeve dhe akteve të tjera të miratuara nga organet e lartshënuara; përcjellje të zbatimit të vendimeve dhe rregulloreve të miratuara në Kuvend; përkthim, lekturim dhe shpërndarje të materialeve; hartim të ekstrakteve të mbledhjeve; informim për aktivitetin e Kuvendit dhe të ekzekutivit nga shërbimi përkatës i këtij Sektori; koordinim të punëve në mes të organeve të Kuvendit, Këshillit të Drejtorëve, komiteteve të Kuvendit dhe komisioneve etj.

#### **c. Sektori i bashkësive lokale**

Gjatë periudhës raportuese, ky sektor ka organizuar bashkëpunimin më të mirë të Komunës dhe qytetarëve, përmes bashkësive lokale, në identifikimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme kryesisht nga lëmi i infrastrukturës. Janë organizuar tubime me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për projektet kapitale për vitin 2013. Gjatë kësaj periudhe kohore janë përgatitur dhe mbajtur zgjedhjet për këshilla dhe kryetarë të këshillave në 33 bashkësi lokale në tërë territorin e komunës së Prishtinës. Zyrat e bashkësive lokale kanë kryer shërbime të ndryshme administrative, ku sipas kërkesave të paleve janë lëshuar gjithsej 27,718 vërtetime për rregullimin e dokumentacionit personal, të drejtave në asistencë sociale, të drejtave të qytetarëve që përkohësisht jetojnë në botën e jashtme etj.

#### **d. Sektori teknik**

Ky sektor ka qenë i angazhuar në mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e objektit të ri dhe të vjetër të Komunës, Arkivin Komunal, 33 bashkësi lokale, 8 zyra të vendit, Qendrën e Regjistrimit Civil, Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale dhe disa zyra në lokacione të ndryshme. Punëtorët e këtij sektori kanë qenë të angazhuar në mbikëqyrjen dhe asistimin gjatë kryerjes së investimeve kapitale në kuadër të Drejtorisë së Administratës, të përmendura më lart. Në disa raste, punëtorët e këtij sektori kanë kryer lyerjen dhe ngjyrosjen e disa zyrave dhe disa meremetime të vogla në objektet e Komunës. Gjatë periudhës raportuese, nga gjithsej 52 automjete sa kanë qenë në qarkullim, gjatë kryerjes së punëve zyrtare janë shënuar gjithsej 615,257 km të kaluara dhe janë shpenzuar 83,132 litra karburant.

#### **e. Sektori i punëve të përgjithshme**

Gjatë kësaj periudhe, ky shërbim ka kopjuar 416,085 faqe materiale të ndryshme për të gjitha drejtoritë, zyrat, njësitë dhe Kuvendin e Komunës. Është bërë klasifikimi i lëndëve të Kuvendit të Komunës, të gjetura në arkivin pasive, prej të cilave një pjesë është bartur në Arkivin Komunal. Në bashkëpunim me komisionin arkivor, është bërë asgjësimi i materialit arkivor në sasi prej 70 metra lineare dhe në bazë të kërkesave të qytetarëve janë kryer 15 lëndë.

#### **f. Sektori i gjendjes civile**

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar këto punë: regjistrime në regjistrin themeltar të lindjes 10,709, regjistrimet në regjistrin themeltar nga bota e jashtme 2,136; kurorëzime

1,300; shkurorëzime 93; regjistrime në regjistrin themeltar të vdekjes 2,812; reregjistrimet 4,153; në procedurë administrative janë nxjerrë 63,786 vendime të ndryshme. Zyrat e gjendjes civile: në Besi janë bërë 571 regjistrime të ndryshme, në Bardhosh 266, në Llukar 453, në Keçekollë 605, në Mramor 529, në Dabishec 247, në Slivovë 90, në Marec 546, si dhe janë lëshuar gjithsej 189,307 certifikata të ndryshme martesore, të lindjes, të shtetësisë, të vdekjes, të vendbanimit, të statusit martesor, të bashkësisë familjare dhe të jetës.

#### g. Zyra për teknologji informatike

Gjatë periudhës raportuese, Zyra për teknologji informatike ka kryer të gjitha punët teknike për aplikimin e teknologjisë informatike për punën me palë. Zyra ka instaluar aplikacionin dhe ka bërë ndërlidhjen e sistemit të intranetit, arkës dhe sistemit të gjendjes civile, ka mbikëqyrë shtrirjen e rrjetit të ri kompjuterik (LAN) pas renovimit të katit përdhës në objektin e vjetër dhe të ri të Komunës etj. Ka procesuar kërkesat për furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e stafit të Qendrës për shërbime me qytetarë, ka asistuar të gjitha organet e Komunës lidhur me aplikimin e teknologjisë informatike etj. Zyra ka qenë e angazhuar në menaxhimin e kontratave që ka Komuna lidhur me fushën e TI-së. Është zbatuar projekti për teleprezenca për ndjekjen “online” të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, janë mirëmbajtur serverët etj.

### IV. AKTIVITETET E ZYRAVE DHE NJËSIVE

#### a. Njësia e personelit

Komuna e ka mbyllur vitin 2012 me 740 të punësuar, të cilët janë në tabelën në vijim, sipas drejtorive, zyrave dhe njësive dhe sipas kualifikimeve, strukturës etnike dhe gjinore. Gjatë periudhës raportuese, marrëdhënien e punës e kanë ndërprerë 18 shërbyes civilë (14 janë pensionuar dhe 4 me vetë dëshirë), ndërkaq marrëdhënie pune kanë themeluar 50 të tjerë. Të gjithë të punësuarit janë me arsim të lartë, gjë që ka kontribuar në rritjen e përqindjes së stafit me arsim të lartë në 34%, nga 26% sa ka qenë në vitin 2009. Kjo pritet të ndikojë në efikasitetin e punës së administratës.

Tabela 11: Numri dhe struktura e të punësuarve në administratën komunale (2012)

	DREJTORITË	Nr.	Kualifikimi				Struktura etnike				Gjinia	
			Fak.	Shk e lartë	Shk. e mesme	Stafi mbësht.	Shqiptar	Serb	Turq	Tjerë	M	F
1	Drejtoria e Administratës	115	12	8	84	11	111	1	2	1 bosh.	94	21
2	Drejtoria e Inspekcionit	57	36	-	21	-	57	-	-	-	40	17
3	Drejtoria e Financave dhe Pronës	76	14	4	57	1	72	4	-	-	44	32
4	Drejtoria e Urb.Ndërt.dhe Mb. së Mjedisit	46	38	1	7	-	45	-	1	-	15	31
5	Drejtoria e Shënd. dhe Mirëq. Sociale	8	6	-	2	-	8	-	-	-	4	4
6	Drejtoria e Infrastrukturës Lokale	20	9	1	10	-	19	-	-	1 bosh.	11	9
7	Drejtoria e Arsimit	24	18	1	5	-	22	-	1	1 bosh.	13	11
8	Drejtoria e Ekonomi dhe Zhvillim	32	15	-	16	1	31	-	1	-	23	9
9	Drejtoria e Kadastrit	36	10	2	24	-	36	-	-	-	22	14
10	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe	7	7	-	-	-	7	-	-	-	-	7

	Sportit												
11	Drejtoria e Shërb. Pub. dhe Shpëtimit	33	11	8	14	-	33	-	-	-	28	5	
12	Zjarrfikësit	114	1	4	109	-	90	24	-	-	111	3	
13	Zyra për marrëdhënie me publikun	1	1	-	-	-	1	-	-	-	1	-	
14	Zyra ligjore	2	1	-	1	-	2	-	-	-	1	1	
15	Zyra e prokurimit	11	8	-	3	-	11	-	-	-	7	4	
16	Zyra e pranimit – pritëse	12	5	1	6	-	11	-	1	-	3	9	
17	Zyra për teknologji informatike	4	1	-	3	-	3	-	-	1 ashk	4	-	
18	Zyra për kthim	4	3	-	1	-	3	1	-	-	2	2	
19	Njësia e auditimi të brendshëm	3	3	-	-	-	3	-	-	-	2	1	
20	Avokatura publike	2	1	-	1	-	2	-	-	-	1	1	
21	Nëpunës për kom. çështje gjinore	1	1	-	-	-	1	-	-	-	-	1	
22	Zyrtare për integritet evropiane	1	1	-	-	-	1	-	-	-	-	1	
23	Institucioni i Mon.dhe Muz. Rajonal	5	-	-	3	2	5	-	-	-	3	2	
24	Arkivi Hist. i Qytetit të Prishtinës	11	3	-	8	-	11	-	-	-	4	7	
25	Biblioteka “Hivzi Sylejmani”	36	7	4	23	2	35	1	-	-	17	19	
26	Qendra e Pioniereve	7	4	-	3	-	7	-	-	-	3	4	
27	Teatri “Dodona” Prishtinë	18	3	-	13	2	18	-	-	-	15	3	
28	Shtëpia e Kult. N.Jugoviq- Hajvali	2	-	-	2	-	1	1	-	-	2	-	
29	Qendra për Punë Sociale	48	27	2	19	-	47	1	-	-	20	28	
30.	Njësia e personelit	4	2	1	1	-	4	-	-	-	1	3	
	GJITHSEJ	740	248	37	436	19	697	33	6	-	4491	249	

VËREJTJE: Në raportin e vitit 2011, numri i përgjithshëm i shërbyesve civilë ka qenë gjithsej 719, duke përfshirë këtu edhe stafin politik, gjegjësisht 11 drejtorët e drejtorive, që do të thotë kanë qenë 708 shërbyes civilë, pa drejtor të drejtorive. Në vitin 2012, janë punësuar gjithsejtë 50 nëpunës të rinj, 14 janë pensionuar, 4 kanë lëshuar punën me vetë dëshirë.

Njësia e personelit ka kryer punë në përputhje me Vendimin për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale dhe dispozitave të Ligjit për shërbimin civil. Është bërë kompletimi i dosjeve të shërbyesve civilë. Është bërë zëvendësimi i kontratave të punës me aktemërimë, në përputhje me Ligjin për shërbimin civil. Janë kryer punët lidhur me procedurat e shpalljes dhe të rekrutimit të shërbyesve civilë, konform Ligjit për shërbimin civil dhe procedurave për rekrutim etj.

## **b. Departamenti i Prokurimit**

Gjatë vitit 2012, janë zhvilluar 297 aktivitete të prokurimit dhe prej tyre janë kontraktuar 235 aktivitete të vlerave të mëdha, të mesme, të vogla dhe me vlera minimale. Nga të gjitha këto aktivitete të prokurimit, vetëm në 6 raste (apo në 2% të aktiviteteve të prokurimit), operatorët ekonomikë kanë ushtruar ankesa kundër vendimeve të Departamentit të Prokurimit. Në të gjitha rastet, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) i ka miratuar prapë zgjedhjet që i ka propozuar Komuna. Ky është tregues i nivelit të lartë të performancës që ka treguar Komuna në respektimin e plotë të Ligjit të prokurimit publik dhe kushteve të tenderimeve.

Në bazë të kërkesave të drejtorive, janë kontraktuar punë, furnizime, shërbime dhe projekte, në shumën prej 32,379,592.00 €. Mbi 85% e prokurimeve kanë të bëjnë me investime kapitale. Ndër më të rëndësishmit dhe më të mëdhatë janë ndërtimet e shkollave, shesheve dhe rrethrotullimit në dalje të qytetit në Veternik. Pjesa prej 6.44% kanë të bëjnë me furnizim me mallra dhe 7.84% për shërbime dhe projekte.

Për prokurimet e kontraktuara në vitin 2012, sipas procedurës së aplikuar, mbi 97% e prokurimeve të kontraktuara kanë qenë me procedurë të hapur apo tender publik. Pjesa tjetër prej 1.56%, kanë qenë pa publikim të njoftimit për kontratë sipas njoftimit të KRPP-së (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik), pastaj 1.04% kuotime dhe 0.09% me vlerë minimale nën 1,000 €. Departamenti i Prokurimit, në bazë të raporteve zyrtare të organeve mbikëqyrëse dhe komisioneve të pranimit, iu ka shqiptuar dënime operatorëve ekonomikë të papërgjegjshëm për vonesa në kryerjen e punëve. Gjatë kësaj periudhe, 46 janë aktivitetet të prokurimit që janë anuluar dhe kanë qenë në procedurë deri më 31.12.2012.

### **c. Zyra për marrëdhënie me publikun**

Zyra për marrëdhënie me publikun (ZMP) prioritet të punës së saj e sigurimin e transparencës dhe të qasjes publike për punën e drejtorëve të Administratës komunale, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe të ndërmarrjeve publike lokale, duke u ofruar informata dhe dokumente qytetarëve dhe mediave. ZMP ka raportuar rregullisht për punët dhe aktivitetet e Komunës së Prishtinës. Janë përcjellë të gjitha takimet protokollare të Kryetarit të Komunës, mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të Këshillit të Drejtorëve, të Komitetit për Politikë dhe Financa, të Këshillit për Siguri në Bashkësi dhe, përmes komunikatave për media, është informuar opinioni publik. Komuna e Prishtinës, gjatë vitit 2012 ka qenë e pranishme në medie të ndryshme, elektronike dhe të shkruara në mbi 720 raste, ku janë dhënë informata të ndryshme rreth punës së Komunës. ZMP ka qenë pjesë e organizimeve të ndryshme, si: debateve publike, përrurimeve, inaugurimeve dhe promovimeve të ndryshme, punëtorive etj. Ka përcjell vazhdimisht shtypin ditor dhe mediat elektronike, dhe ka veçuar tekstet në faqet e gazetave ku shkruhet për Komunën e Prishtinës, duke i ruajtur dhe arkivuar ato. Gjatë vitit 2012, ZMP-ja ka nxjerrë një mori publikimesh, siç është broshura “E drejta për qasje në informata publik”, e punuar në bashkëpunim me OSBE-në. Ka punuar në publikimin e buletinit, ku do të prezantohen projektet e realizuara dhe aktivitetet tjera në Komunën e Prishtinës në vitin 2012.

### **d. Zyra ligjore**

Zyra ligjore ka vazhduar me kryerjen e detyrave dhe punëve të parapara me ligj, akte nënligjore, Statutin e Komunës, rregullore, vendime dhe urdhëresa, me aktin për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës për shërbyesit civilë të organeve të administratës së Komunës së Prishtinës. Zyra ligjore ka dhënë këshilla për administratën komunale, institucionet e kulturës dhe të shëndetësisë, ndërmarrjet publike lokale, trupat e Kuvendit etj. Ka shqyrtuar të gjitha projektpropozimet (rregulloret, vendimet), të cilat i janë dërguar Zyrës nga ana e drejtorive, institucioneve të kulturës dhe shëndetësisë dhe kryeshefave ekzekutivë të ndërmarrjeve publike lokale. Ka përpiluar urdhëresat administrative nga Kryetari i Komunës, që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punëve të organeve të administratës. Ka marrë pjesë në Kolegjin e zyrtarëve ligjor, të themeluar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, dhe në takime të tjera lidhur me qeverisjen lokale në përgjithësi. Ka bashkëpunuar me institucionet e Qeverisë së Republikës së

Kosovës, komunat e tjera, OJQ-të, komunitetin e biznesit, organet e administratës, institucionet arsimore, shëndetësore dhe ndërmarrjet publike të komunës etj.

#### **e. Zyra e përfaqësimit juridik**

Zyra e përfaqësimit juridik ushtron mjetet për mbrojtjen juridike të të drejtave dhe interesave të Komunës. Gjatë periudhës raportuese janë trajtuar 513 lëndë, prej të cilave 175 janë të bartura nga vitet paraprake dhe lëndë të reja janë 338. Për të gjitha këto lëndë, Komuna është përfaqësuar nëpër gjykata në 624 seanca gjyqësore dhe janë ushtruar 84 ankesa, 3 revizione, 6 kundërshtime, 2 padi, 6 parashtresa, 2 kallzime penale, 215 përgjigje në padi, 41 njoftime, 133 kërkesa për shënime dhe 84 të ndryshme. Po ashtu, kanë arritur 187 aktgjykime, 161 aktvendime, 28 ankesa, 2 revizione, 5 parashtresa, 9 ekspertiza, 211 padi, 3 propozime për ekzekutim, 565 të ndryshme. Për nga natyra e kontesteve, lëndë civile pronësore janë 76, konteste pune 32, konteste administrative 116, procedura penale 30, kompensim pagash 186, kompensime 21, eksproprijim dhe shpronësim 15, kallzime penale 4, lëndë ekzekutuese 5, konteste për pengim posedim 2, masa të sigurisë 4, konteste banesore 10, konteste për kompensim borxhi 9, kundërvajtje 3. Duke u nisur nga numri i gjithmbarshëm i lëndëve në procedurë dhe mënyrën e zhvillimit të procedurës, gjatë periudhës raportuese kanë përfunduar si lëndë të kryera 159. Lidhur me lëndët, të cilat janë në procedurë e sipër, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, duke ushtruar mjete të rregullta juridike, si dhe mjete të jashtëzakonshme juridike.

#### **f. Njësia për auditim të brendshëm**

Gjatë vitit 2012, Njësia auditimit të brendshëm (NJAB) ka përfunduar raportin e auditimit të pasurisë dhe raportin e të hyrave të Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Nga raporti i auditimit të pasurisë, që përfshin periudhën janar 2011 deri në maj 2012, janë bërë vlerësimet e nevojshme dhe janë nxjerrë 13 rekomandime, të cilat kanë filluar t'i zbatojnë zyrtarët përgjegjës. Nga raporti i auditimit të të hyrave të Drejtorisë së Shërbimeve Publike janë nxjerrë 9 rekomandime, për të cilat menaxhmenti i drejtorisë e ka përpiluar planin për zbatimin e tyre. Gjatë muajt dhjetor, NJAB-ja ka filluar me auditimin e procedurave të prokurimit për vitin 2012 dhe auditimin e të hyrave nga Drejtoria e Urbanizimit. Në përputhje me nenin 14 të Ligjit për auditimin e brendshëm (nr 03/L-128), Njësia e auditimit ka përpiluar planin vjetor të punës për vitin 2013 dhe planin strategjike 2013-2015. Gjatë vitit 2012, stafi i NJAB-së ka ofruar shërbime këshilluese për gjithë zyrtarët e sektorëve dhe të drejtorive komunale, si dhe ka bashkëpunuar ngushtë me zyrën e auditorit të përhershëm dhe NJQH-AB. NJAB-ja nuk ka arritur që të përmbushë planin e punës për vitin 2012, të aprovuar nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm të Komunës së Prishtinës, i cili plan pastaj është miratuar edhe nga Njësia Qendrore e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave. Në muajin dhjetor janë caktuar anëtarët e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, në përputhje me Udhëzimin administrativ që rregullon funksionimin e komiteteve të auditimit të brendshëm dhe me rekomandimin e Auditorit të Përgjithshëm.

### **g. Zyra komunale për integrim evropian**

Zyra komunale për integrim evropian punën e saj e bazon në veprimet që dalin nga Plani i veprimit për partneritet evropian (PVPE). Por, duke pasur parasysh që viti 2012 ka qenë vit i disa ndryshimeve sa i përket procesit të Integritimit Evropian, ku nga Komisioni Evropian u vendos për një studim të fizibilitetit për Kosovën, edhe Plani i veprimit për partneritet evropian ndryshoj në Planin e veprimit për studimin e fizibilitetit. Bazuar në veprimet e këtij plani dhe me kërkesë të MAPL-së, është raportuar në fillim të muajit maj. Vlen të cekem takimet e rregullta të Kolegjiumit të Zyrtarëve Komunalë për Integritime Evropiane (ZKIE), me qëllim të rritjes së efikasitetit të procesit në nivel lokal, ku janë mbajtur 5 takime, duke u përmbyllur me punëtorinë dyditore në Durrës, të përkrahur nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe GIZ-i. Janë mbajtur takime me misionin faktmbledhës për Programin IPA 2014 - 2020. Zyra ka marrë pjesë në programin trajnues të Komisionit Evropian TAIEX, më 12-15 mars 2012, me temën “Shfrytëzimi eficient i fondeve strukturale” në Bruksel. Zyra ka marrë pjesë aktivisht në takimet e rregullta të Komisionit Komunal për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, si dhe ka bashkëpunuar ngushtë me Zyrën për kthim dhe komunitete, pastaj në konferencën dyditore në Prishtinë, me temën “Vendimmarrja në nivelin lokal” më 15-16 maj 2012, në Konferencën e Tretë Ndërkombëtare për Vetëqeverisje Lokale, më 14 -15 shtator në Prishtinë dhe Komunën e Novobërdës, në takimet me AZHR-në Qendër. Zyra ka qenë aktivisht e angazhuar në monitorimin e projektit ‘Zhvillimi ekonomik përmes promovimit të turizmit rural’.

### **h. Njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore**

Janë realizuar disa aktivitete, duke shfrytëzuar bashkëpunimin e drejtorive përkatëse, si dhe të organizatave lokale. Me themelimin e grupi të grave që janë këshilltare në Kuvendin e Komunës dhe nga shoqëria civile, është përgatitur plani i punës dhe janë bërë vizita në Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, si dhe grave kryefamiljare dhe familjeve të dëshmorëve. Në mars 2012, është mbajtur trajnimi kundër trafikimit. Me rastin e 22 prillit (Ditës Ndërkombëtare të Tokës), është mbajtur fushatë vetëdijesimi mbi mbrojtjen e natyrës. Më 1 qershorit, në bashkëpunim me Qendrën e Fëmijëve, është mbajtur shfaqje teatrale kundër punës së fëmijëve, pastaj trajnimi në viset rurale për të drejtat e njeriut, për rolin e femrës në trashëgimi familjare etj. Me rastin e hapjes së fushatës për promovimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara, janë punësuar në Komunë për 2 ditë 10 persona me aftësi të kufizuara, si dhe janë mbajtur tryeza diskutimi. Zyrtarët e kësaj njësie kanë marrë pjesë në shumë takime nga MAPL, Agjencioni për Barazi Gjinore, Zyra për Qeverisje të Mirë, Fondacioni “Terre des homes”, ILO, OSBE, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione etj. Të gjitha aktivitete janë financuar nga buxheti i Komunës. Është shënuar edhe ‘25 Nëntori - Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas’, ku janë zhvilluar aktivitete për 16 ditë. Në mes tjerash, në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sporte janë shpërnda fletushkat dhe kordelet e bardhë si simbol i këtyre ditëve, pastaj janë mbajtur tryeza të rrumbullakëta me qëllim vetëdijesimi për pasojat që shkakton dhuna.

## **i. Zyra për kthim dhe komunitete**

Qasja e komuniteteve jo shumicë në shërbimet publike gjatë vitit 2012, është e kënaqshme në të gjitha institucionet komunale. Të drejtat e komuniteteve respektohen konform infrastrukturës ligjore dhe Kushtetuese. Me vendim të Kryetarit të Komunës, është formuar Komisioni Komunal për Riintegrim, që si qëllim kryesor ka riintegrimin e personave të riatdhesuar. Zyra ka marrë pjesë rregullisht në 12 takimet e Komitetit për Komunitete, ka bashkëpunuar me ministritë përkatëse që merren me çështje të komuniteteve, ku janë diskutuar politikat qeveritare për riintegrimin e personave të riatdhesuar, funksionimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, zbatimin e vendimeve nga Zyra për Riintegrim në MPB, respektimi i të drejtave të komuniteteve, procesi i kthimit të të zhvendosurve dhe çështje të tjera. Gjatë vitit 2012, janë zhvilluar dy takime për kthimin e tri familjeve të të zhvendosurve serb. Janë zhvilluar takime dhe punëtori nga OSBE-ja lidhur me çështjet dhe problemet e riintegrimit të personave të riatdhesuar, duke respektuar Rregulloren 10/2012. Janë mbajtur takime mujore me zyrtarë të UNHCR-së dhe të KAAD-së, ku është shqyrtuar plani mujor i zyrës dhe çështjet e të drejtave të komuniteteve jo shumicë. Në bashkëpunim me IOM-in, është realizuar projekti EU-CSP II, që kanë përfituar katër pjesëtarë të komunitetit jo shumicë. Gjatë vitit 2012, janë riintegruar 7 familje me 24 anëtarë dhe 22 individë (Prej tyre janë 2 familje të komunitetit shkali, me 7 anëtarë, 1 familje e komunitetit rom, me dy anëtarë, dhe 4 individë të komunitetit ashkali). ZKKK-ja ka proceduar dy projekte në mekanizmat e organizatave ndërkombëtare, të cilat do të merren si pika referimi/integrimi në projektet e tyre përgjatë vitit 2013. Kjo zyrë i ka kushtuar rëndësi kornizës ligjore dhe strategjike për respektimin e plotë të të drejtave të komuniteteve.